MBYLLET HETIMI ▶ Faqe 14
Zhdukja e ditarit të Enver Hoxhës, akuza tërhiqet

KUSHERIRA E DEPUTETES ▶ Faqe 17
Vrasja e Aurora Trashanit, bie akuza për emigrantin

DESHMIA E TRAFIKANTIT ▶ Faqe 16
"Heroinën e bleva 30 mijë euro në një lokal në Tiranë"

EMRAT E PERFITUESVE ▶ Faqe 20-22
Lista, 3289 familjet që marrin kredi për shtëpi

[SHQIPTARJA.com]
LEKË 30
VITI II - NR. 210 E mërkurë, 05-09-2012

TELEVIZIONI MË I RI INFORMATIV NË SHQIPËRI
A1 REPORT!
origjina e lajmit...

FOTOT EKSKLUZIVE

Zbulohet sipërmarrja afër Sharrës. Lulëzoi pas dhunës ndaj romëve

# PLEHRAT, JA FIRMA QE MBLEDH MILIONAT

Pika e grumbullimit të mbeturinave, në komunën Vaqarr. Makinat marrin plehrat për t'i paketuar në firmën e re. Ekspertët: Fitimi shkon në 10 milionë lekë në muaj. Firma, asnjë detaj për biznesin

*Lajmi*

**Shtohet misteri rreth firmës, së cilës i është besuar grumbullimi dhe më pas shitja për riciklim i mbeturinave të Tiranës. Pika e grumbullimit e ndërtuar pak më larg Sharrës, është rritur frikshëm, krahasuar me muajt e parë kur edhe nisi fillimisht aktivitetin.**

TIRANE

ESMERALDA KETA

Thuajse 1 km larg pikës së grumbullimit të Sharrës, ku shkarkohen të gjitha mbeturinat urbane që krijohen në Tiranë, prej muajsh është ngritur një pikë e re e grumbullimit të tyre. "Shqiptarja.com" e vizitoi këtë pikë edhe gati një muaj e gjysëm më parë, kur policia bashkiake nisi gjuetinë ndaj... ▶ vijon në faqe 11



**Në foto:** Pamje nga pika e grumbullimit të mbeturinave që është ndërtuar 1 km larg Sharrës

HETIMI NE SHISH

## PD kërkoi dosjen e Xhoanës në 2002

Fatos Klosi: Fatos Nano donte vetë që të verifikohej e shoqja

TIRANE

JAKIN MARENA

Ish-kreu i SHISH Fatos Klosi thotë se ish-kryeministri Fatos Nano kishte kërkuar vetë verifikimin e pozicionit të së shkuarës së bashkëshortes së tij Xhoana Nano. Ai thotë se të gjithë të afërmit e zyrtarëve të lartë duhen verifikuar për të shkuarën tyre. Shpjegon keqkuptimet ne Nanon si dhe flet për Visho Ajazin... ▶ Faqe 2



**Në foto:** Fatos Nano me bashkëshorten, Xhoanën

NE SLLOVENI ▶ Faqe 10

**Berisha e pranon: "Shqipëria është në krizë"**

IMUNITETI DHE REFORMAT ▶ Faqe 4-7

**Rama: Pas 10 muajsh rrugë e re, ose rrënim**

Brukseli apel. Flasin Gramoz Ruçi dhe Eglantina Gjermeni



NERANXI 1991
... gjithmonë një hap përpara...
Shurupe për kokteile dhe likerëra për bare dhe restorante
Adresa: Autostrada Tiranë- Durrës, km 7, Yrshek Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502: e-mail: neranxi@neranxi.com: www.neranxi.com

Koment



NGA PREÇ ZOGAJ

## Zhbërja, parullë apo projekt?

Duke qenë se fati këto njëzet e dy vjet më ka mbajtur shumicën e kohës në opozitë, më ka ndodhur të përballen shpesh me një set pyetjesh të një emeruesi të përbashkët? A do të vendoset ndonjëherë drejtësia? A do të shkojë haka te i zoti? A do t'i kthejnë pasuritë ata që i kanë marrë me korrupsion dhe abuzime? A do të zhbëhen aferat korruptive që ka denoncuar e denoncon opozita? A do të dalë dikush t'i thotë stop njeherë e mirë kësaj xhungle shumëvjeçare ku rendin, aq sa është, e ruan kryesisht zakoni dhe jo ligji? A do të dalë dikush të bëjë shtet pa prekur liritë dhe të zhvillojë liritë pa dobësuar shtetin?

Janë pyetje që kanë brënda shqetësim qytetar; pyetje që burojnë nga njohja dhe përvojat vetjake e shumë qyetarëve; pyetje që nuk burojnë nga njohja dhe përvojat vetjake, por bazohen në denocimet e opozitës dhe mediave për korrupsionin; pyetje të likujdueshme me një "po" populiste nga një politikan populist, por të vështira në thelb, nëse duan të rrimë shtrembër e të flasim drejt. Unë që nuk besoj te heronjtë kordhëtarë dhe as në shpatën e mprehur të drejtësisë politike të udheheqësit, kam dhjetë vjet apo pesëmbedhjetë vjet që hesht kokulur kur më bëhën pyetje të tilla dhe mendohem gjatë para se të them ndonë fjalë. Nuk kam dashur të iludoj njeri me përgjigje te lehta sa për të kaluar radhën. Nuk kam dashur e nuk dua të bëj politikë, të mashtroj apo të gënjej duke luajtur me dëshirën organike të publikut për drejtësi apo, më keq akoma, me një defekt karakterial që i vishet shqiptarit, sikur ky gëzohet më shumë kur sheh t'i dalë flaka shtëpisë së... ▶ vijon në faqe 8

## Ngjela: Saliu thotë që drejtësia dhe ligji jemi vetëm ne

**Komunizmi ka qenë një korrupsion i ëndrrës për drejtësi që kanë pasur gjithmonë shoqëritë. 20 vitet tona të postkomunizmit kanë qenë korrupsion për të mos u vendosur kurrë drejtësia. Komunizmi e kishte kthyer besimin e ëndrrës së drejtësisë në fe me të cilën shtypte dhe vriste. Kurse, në këta 20 vjet pas tij, në Shqipëri vidhet, poshtërohet dhe fyhet shoqëria, me mendimin se "drejtësia dhe historia jemi ne", domethënë, unë Saliu". Kjo ka qënë deklarata e avokat Ngjelës, në facebook. Sipas të cilit, injoranca e krimi ka pushtuar Shqipërinë dhe shqiptarët heshtin, ndonëse shteti është shumë i dobët për të ushtruar dhunë. "Mos ndoshta tani s'ka më nevojë, sepse ne jemi mësuar me poshtërimin?", pyet Ngjela. Njëherësh ai nënvizon se është e ardhmja që gjithmonë vendos ligjet e së tashmes, por kurrë ato ligje nuk vlejnë, nëse nuk e përfillim të tashmen. "Defekti i ne shqiptarëve është se, duke qenë të paaftë për të tashmen, kemi qenë të paaftë të vendosim ligjet dhe për të ardhmen. Këtu, në këtë pikë na kanë goditur gjithmonë sundimtarët tanë: ata nuk na kanë lënë që të jemi zotërit e së tashmes sonë, që, në fakt, të humbasim dhe të ardhmen. Këtu ka goditur edhe Saliu", thotë Ngjela.**

### Ish-kreu i SHISH: Marrëdhëniet me Nanon, Visho Ajazin e ç'pritet në të ardhmen

# Klosi: Nano kërkoi vetë që të verifikohej Xhoana

*"Familjarët e zyrtarëve duhen verifikuar. Këtu sillen si mbretër"*



### Lajmi

**Ish-kreu i SHISH Fatos Klosi thotë se ish-kryeministri Fatos Nano kishte kërkuar vetë verifikimin e pozicionit të së shkuarës së bashkëshortes së tij Xhoana Nano. Ai thotë se të gjithë të afërmit e zyrtarëve të lartë duhen verifikuar për të shkuarën tyre. Shpjegon keqkuptimet ne Nanon si dhe flet për Visho Ajazin.**



Ish-kreu i SHISH, Fatos Klosi

TIRANE

Jakin Marena

Ish-kreu i SHISH Fatos Klosi në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" ka deklaruar se ish-kryeministri Fatos Nano ka kërkuar vetë verifikimin e të shkuarës së bashkëshortes së tij Xhoana, pas versioneve të shumta të dhëna nga ana e mediave në lidhje me pozicionin e saj përpara se të njihej me ish-liderin e socialistëve. Shpjegim që është dhënë referuar një deklarate të ish-kreut të SHISH Petrit Myftari i cili kishte kërkuar të dhëna për Xhoanan. Klosi thotë se në asnjë vend të botës shteti nuk është indiferent ndaj këtyre rasteve, pavarësisht se në Shqipëri shefat apo drejtuesit e quajnë absurd të dyshohet tek ata. Ndërkohë ai saktëson se në marrëdhëniet me Nanon kishte pasur vetëm keqkuptime, pavarësisht se sipas tij sollën shkarkimin. Klosi flet dhe për kreun e ri të SHISH, duke nënvizuar faktin se varet çfarë urdhërash merr për të parë sjelljen e tij në zgjedhje ndërsa nuk preferon të komentojë faktin se si shpjegohet që tre nga 6 ish-krerët e SHISH janë ndarë nga jeta në moshë të re.

**Në një intervistë 6 vite më parë njeriu që mori përkohësisht drejtimin e SHISH pas largimit tuaj, ish-zv.kreu i SHISH Petrit Myftari ka treguar se ka urdhëruar kontrollin e mbajtjen nën survejim të bashkëshortës së ish-kryeministrit Fatos Nano, zonjën Xhoana Nano. Si e komentoni një deklaratë të tillë?**

Deklaratën e të ndjerit Petrit Myftari nuk e kam ditur më parë. Me sa mbaj mend unë, natyrisht me të dhëna të shtypit të kohës, vetë kryeministri ka kërkuar një verifikim të pozicionit të të shoqes, pasi mediat kishin dhënë versione të ndryshme për këtë pozicion. Në deklaratën e botuar nuk thuhet se zonja e kryeministrit është mbajtur nën survejim, por thuhet se është kontrolluar për të dhëna të mundëshme, lidhur me lidhjet e supozuara, janë gjëra fare të ndryshme. Sipas meje, Z.Nano që kur u njoh me Zonjushën, megjithëse nuk ishte atëherë në ndonjë detyrë shteterore, mund të kish kërkuar një verifikim, meqënëse kish në mëndje të bëhej president dhe pastaj u bë kryeministër. Në asnjë vënd të botës shteti nuk është indiferent në raste të tilla. Në Shqipëri, shefat, gjithmonë, vëndin e kanë quajtur "të tyren" dhe i quajnë absurde dyshimet tek ata vetë apo tek të afërtit e tyre. Eshtë një pjesë e konceptit që "shteti jam unë".

> **"Me sa mbaj mend unë, natyrisht me të dhëna të shtypit të kohës, vetë kryeministri ka kërkuar një verifikim të pozicionit të të shoqes, pasi mediat kishin dhënë versione të ndryshme për të"**

**Mendoni se kishte ndonjë arësye që bashkëshortja e ish-kryeministrit të mbahej nën vëzhgim për lidhje me agjenturat e huaja?**

E thashë më parë, që në deklaratën e bërë nuk flitet për vëzhgim por për kontroll të të shkuarës. Prap sipas meje, nuk ka asgjë të jashtëzakonshme, në një fazë të parë të trajtimit të problemit mendoj se nuk duhej "shqetësuar" Kryeministri, pastaj, nëqoftëse, të dhënat e para tregojnë se duhet shkuar më tutje, patjetër duhet marrë miratimi i Kryeministrit, për trajtime të mëtejshme. Por kam frikë se përpara dhënies së miratimit, një Kryeministër shqiptar, do ta shkarkonte më parë shefin e Shërbimit.

**Mediat kanë shkruar asokohe se dhe kërkesa për shkarkimin tuaj kishte pikërisht si bazë informacionet sipas të cilave Xhoana Nano dyshohej për lidhje me shërbimet e huaja, shqetësim që ia paraqitët dhe ish-kryeministrit. Cila është e vërteta?**

Nuk janë aspak të vërteta këto shkrime. Z.Nano asokohe, më parë u armiqësua me mua dhe pastaj kërkoi shkarkimin tim, nisur nga një emision i ciklit "Ajsberg", ku Z.Artur Çani kërkonte që meqënëse Z.Nano kërkonte të bëhej president, ishte e drejtë e shqiptarëve, që t'u sqaronte disa probleme lidhur me sjelljet e tija dhe me të shoqen. Servilët që i vinin rrotull, ia kishin mbushur mëndjen, që emisionin e kisha mbështetur unë, dhe që nga ajo ditë ai as pranoi të më takonte dhe të më dëgjonte, dhe kur u bë Kryeministër kërkoi shkarkimin tim. Unë s'kisha asnjë lidhje me emisionin dhe besoj se këtë tashmë Z.Nano e di. Z.Çani gëzon shëndet të mirë dhe është pyetur besoj, ose mund të pyetet në çdo kohë lidhur me atë emision.

**Mendoni se familjarët e ish-kryeministrave por dhe të krerëve të partive politike që aspirojnë të jenë në krye të qeverisë apo të shtetit kalojnë gjithnjë në një filtër verifikimi dokumentacioni dhe informacioni. Ka pasur të tillë në kohën kur ju ishit kryetar i SHISH për ish-kryetarin e shtetit, ish-Kryeministrat, ish-kreun e opozitës apo krerët e tjerë të institucioneve të rëndësishme, gjithnjë në funksion të sigurisë kombëtare?**

Mendoj se është e domosdoshme që sqarime lidhur me politikanët që aspirojnë detyra të larta në shtet apo për familjarët e afërt të tyre, duhen kërkuar nga institucione të ndryshme të shtetit. Fatkeqësisht, kjo gjë nuk ka traditë dhe akoma nuk bëhet, për mua është e gabuar. Kjo situatë pasqyron faktin që politika është mbi shtetin, që shteti quhet gati "pronë e politikanëve", dhe ky është fakt i njohur. Një grup politikanësh, që mbase as kanë fituar tamam me votime e që qeverisin me aleanca të pista, pretendojnë se mund të bëjnë gjithçka me shtetin, me Kushtetutën dhe ligjet e tij. Ju duket vetja mbret dhe shkuar mbretit, paçka se janë në ato poste vetëm për të administruar punët e shtetit. Duhet të vendoset sa më parë praktika (kush do ta bëjë?), që ndryshimet në Kushtetutë apo në ligjet e rëndësishme të shtetit të propozohen në një legjislaturë dhe të aprovoheshin (nëqoftëse) vetëm në legjislaturën tjetër, që populli ta jepte opinionin e vet gjatë zgjedhjeve pollitike.

**Në krye të SHISH është rikthyer ish-zëvendësi i Gazidedes, Visho Ajazi Lika, që në vetëm pak javë ka ndryshuar drejtimin e SHISH në 12 qarqet e vendit por dhe në qendër. Si e konsideroni këtë "fshesë" dhe sa ndikim do ketë në punën e SHISH, kur vendi në më pak se një vit hyn në zgjedhjet parlamentare?**

Ai për këto punë është emëruar. Sigurisht për Shërbimin kjo do të jetë një kthim i madh mbrapa, në filozofinë e në profesionalizmin e punës. Sa për kohën që na ndan nga zgjedhjet, me eksperiencën që kanë, besoj se do t'i mjaftojë koha për të kryer detyrat që do t'u ngarkohen.

> **"Mendoj se është e domosdoshme që sqarime lidhur me politikanët që aspirojnë detyra të larta në shtet apo për familjarët e afërt të tyre, duhen kërkuar nga institucione të ndryshme të shtetit"**

**Mendoni se SHISH mund të përzihet në jetën politike dhe probleme të tjera, që ishin harruar që nga koha e të ndjerit Gazidede?**

Këtë është më mirë t'ja lëmë kohës të na e tregojë.

**Meqë përmendëm të ndjerët, si shpjegohet që nga 6 ish-krerët e Shërbimit Sekret, vetëm 3 prej tyre vazhdojnë të jetojnë?**

Këto nuk janë probleme të tokësorëve, prandaj nëqoftëse keni ndonjë mundësi, pyetini ata.

### Ish-kreu i SHISH

## "Myftari: Po, kontrolluam Xhoana Nanon"

Ish-kreu i SHISH më 2004, Petrit Myftari deklaroi në revistën "MAPO" se kishte kërkuar informacion për të shkuarën e Xhoana Nanos. "Në media, por dhe nga segmente të caktuara të politikës, zonja Xhoana Nano ishte akuzuar për lidhje me agjenturën e një vendi fqinj, Greqinë, ku ajo kishte jetuar për një periudhë kohe. Duke zbatuar ligjin, u kërkova të gjithë drejtorëve të arkivave që ishin në varësi të Shërbimit, të kontrollonin për të dhëna të tilla të mundshme. Mbas këtij kontrolli nuk rezultoi asgjë e tillë. Por ndërkohë, urdhri im ishte mësuar nga kryeministri. Ai më kërkoi në zyrë dhe, dukshëm i pezmatuar, më pyeti se si ishte e mundur që as për një gjë të tillë, kaq drejtpërdrejt e lidhur me vetë atë, nuk e kisha vënë në dijeni. Kryeministri ishte i pakënaqur dhe më kërkoi që një përgjigje të tillë ta jepja edhe me shkresë zyrtare. "Është e pamundur, i thashë, për të prodhuar një shkresë të tillë, më duhet një shkresë zyrtare nga ju. Vetë e kam të pamundur të jap një përgjigje zyrtare pas një kërkese gojore", iu përgjigja atëherë, dhe po atë moment (ishte pothuaj mesnatë) kjo shkresë m'u dha në dorë", deklaroi asokohe Myftari.

## Celibashi: Kreu i KQZ i pastër, duhet një figurë e re

**Një ditë pasi Kuvendi shpalli vakancën për postin e kryetarit të KQZ-së, ish-numri një i këtij institucioni, Ilirjan Celibashi, deklaron se në krye të tij duhet të vendoset një figurë e papërfolur. Qoftë një imazh i ri apo riciklimi i një anëtari aktual të KQZ, pasuesi i Ristanit, sipas Celibashit, duhet minimalisht të mos ketë qenë pjesë e sulmeve politike. "Mirë do të ishte që në krye të KQZ të ishte një personalitet i spikatur në aspektin profesional dhe personal dhe padiskutim jo dikush, i cili që në fillim të garës të ishte i paragjykuar apo i papranuar, qoftë dhe për një pjesë të politikës. Kjo nuk do e ndihmonte procesin, nuk do të kontribuonte për një besim të të gjitha palëve në procesin zgjedhor. Mendoj që ndoshta një kandidat që është i papërfoluar nga çdo pikpamje, do të ishte një zgjidhje e mirë", deklaroi Celibashi. Po aq kujdes, sipas tij, partitë politike duhet të tregojnë dhe për 6-shen tjetër të KQZ-së, dhe jo thjesht te bëjnë ndërrimin e emrave. Kuvendi hapi të hënën konkursin publik për të përzgjedhur njeriun që do të menaxhojë zgjedhjet e ardhshme.**



**Në foto:** Fatos Nano me bashkëshorten, Xhoanën

### Hetimi i PD-së, 10 vite më parë në SHISH-in e Myftarit

# Xhoana, Berisha e dinte për kërkesën e Ngjelës

*Artikulli që jepte prapaskenat e përplasjeve politike*

**TIRANE**

Sipas të dhënave të botuara në media, 10 vite më parë, anëtarët demokratë të Komisionit Hetimor për SHISH-in kërkuan nga drejtori i komanduar, i ndjeri Petrit Myftari, të dhëna për bashkëshorten e kryeministrit të asaj kohe Fatos Nano. Por kjo kërkesë do të prishte paktin me Berishën, që ai kishte vendosur me zgjedhjen e presidentit konsensual, Moisiu. Më poshtë është artkulli i marrë nga "Koha Jonë" në shtator 2002:

"Rrezikohet seriozisht marrëveshja Nano-Berisha. Pas skandalit të djeshëm, lidhur me kërkesën e kryetarit të Komisionit Hetimor të Rendit dhe SHISH-it ndaj SHISH-it për një dosje të Xhoana Nanos, bashkëshortja aktuale e kryeministrit Fatos Nano, ngjarjet për këtë komision dhe vetë politikën duket se kanë ndryshuar.

Burime të sigurta pranë Spartak Ngjelës, pohuan dje për "KJ" se për kërkesën e bërë në adresë të institucionit të SHISH-it, ka pasur dijeni edhe kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha. Burimet nuk saktësojnë nëse vetë Berisha ka udhëzuar Ngjelën për një veprim të tille, por thonë se ai ka qenë në dijeni të një kërkese të tillë të bërë nga kryetari i Komisionit hetimor ndaj SHISH-it.

Por një fakt i tillë rrezikon seriozisht marrëveshjen Nano-Berisha. Burime pranë kryeministrit thane dje për "KJ" se Nano e ka marrë vesh faktin se Berisha është vënë në dijeni për këtë çështje. Kreu i pozitës nuk mund të qëndrojë indiferent, pas kërkesës që një nga anetaret e komisionit ka bërë në adresë të kryetarit të SHISH-it për dosjen e Xhoana Nanos. Edhe pse në përfundim të të gjithë këtyre fakteve dhe deklaratave, për Xhoana Nanon nuk ekziston asnjë dosje në SHISH, sipas informacionit zyrtar, kjo kërkesë, ka minuar marrëveshjen Nano-Berisha.

Sapo anëtarët socialistë të grupit hetimor kanë marrë vesh mbi kërkesën personale të Spartak Ngjelës në SHISH, janë mbledhur dje pasdite për të marrë masa të menjëhershme ndaj kryetarit të komisionit. Një nga deputetët socialistë të këtij grupi tha dje për "KJ" se pesë anëtarët e pozitës në këtë komision, do të kërkojnë një mbledhje të jashtëzakonshme të Komisionit për të shkarkuar nga detyra e kryetarit të Komisionit hetimor të Rendit dhe SHISH-it, Spartak Ngjelën. Mbledhja mund të zhvillohet gjatë ditës së sotme, ose të pritet mbledhja e radhës, por arsyeja që deputetet e pozitës do të japin për shkarkimin e Spartak Ngjelës nga posti i kryetarit është "kërkesa personale e tij për të marrë informacione nga Shërbimi Informativ i Shtetit, pa vënë në dijeni anëtarët e këtij komisioni". Raporti i votave në komision mbetet pesë me katër në favor të pozitës, por duket se vendimet e ndërmarra deri më tani nga ky komision kanë qenë në favor të opozitës. Megjithatë Spartak Ngjela duket se nuk do ta ketë të lehtë pas incidentit që ai vetë shkaktoi me bashkëshorten e kryeministrit, pavarësisht se Ngjela do të mbrohet nga deputetët e opozitës në këtë komision.

Spartak Ngjela, kryetar i komisionit, kërkoi materiale hetimore në SHISH, pa vënë në dijeni anëtarët e tjerë të komisionit të posaçëm parlamentar. Tri dite më parë ai ka përpiluar një shkresë zyrtare ku ka kërkuar nga drejtori i komanduar i SHISH-it, Petrit Myftari, dosjen ku kishte të dhëna mbi jetën e bashkëshortes së kryeministrit Fatos Nano, Xhoana Nano. Ky fakt është bërë objekt debati në mbledhjen e radhës të zhvilluar dje, midis kryetarit Ngjela dhe përfaqësuesve të PS-së në komision. Anëtarët socialistë të komisionit kërkuan sqarime nga Ngjela, lidhur me këtë veprim të tij, për një informacion që nuk është objekt i punës hetimore të komisionit, aq më tepër pa u vënë në dijeni anëtarët e komisionit. Nënkryetari i komisionit Bashkim Fino, deklaroi dje pas mbledhjes se veprimi i bërë nga Ngjela ka cënuar punën e komisionit, pasi ceceshtja në fjalë nuk është fare objekti i hetimit. "Ne kemi kërkuar prej tij që ai të japë sqarime për këtë çështje. Ç'punë ka komisioni me bashkëshorten e kryeministrit?", tha Fino per "KJ". Por pas akuzave që Fino bëri në media dje, kryetari i këtij komisioni Spartak Ngjela është detyruar të pranojë se i ka kërkuar kryetarit të SHISH-it, Myftari, informacione që lidheshin me lidhjet e përfolura të bashkëshortes së kryeministrit me një agjenturë të huaj. Sipas Ngjelës, shkak për këtë është bërë një emision në një televizion privat, i cili e akuzonte znj. Nano se punonte për Asfalinë greke. Por nga ana tjeter, shërbimi sekret shqiptar kishte marrë i pari të gjitha informacionet e nevojshme. Sipas Ngjelës kreu i komanduar Myftari, konfirmon se ky shërbim nuk ka asnjë të dhënë për përfshirjen e Xhoana Nanos në agjenturat e huaja. "Nuk ka asnjë dosje në asnjë dokument që të ngarkoje znj. Xhoana Nano me çështjen për të cilën është akuzuar nëpërmjet një emisioni", tha Ngjela. Ai e mbron si të ligjshme kërkesën e tij drejtuar SHISH-it, e cila siç pohon vetë ai është pasuar nga 11 shkresa të tjera zyrtare, objekti i të cilave është sekret. Ndërkaq Ngjela thotë më tej së anëtarët socialistë të komisionit e bënë publik këtë çështje për të sulmuar Kryeministrin Fatos Nano. I gjithë debati lindi pas daljes në një televizion privat të ishkreut të SHISH, Fatos Klosi. Kur Klosi u pyet nga gazetarët, nëse kishte dijeni se bashkëshortja e kryeministrit jep informacion tek agjenturat e huaja, ai u përgjigj: "Nuk bëj komente për këtë problem. Kam folur në institucionet përkatese". Pas kësaj, filloi edhe procesi i hetimeve për Xhoana Nanon"



Spartak Ngjela dhe Sali Berisha

### Kërkesa

Kryetari i komisionit Spartak Ngjela është detyruar të pranojë se i ka kërkuar kryetarit të SHISH-it, Myftari, informacione që lidheshin me lidhjet e përfolura të bashkëshortes së kryeministrit me një agjenturë të huaj. Sipas Ngjelës, shkak për këtë është bërë një emision në një televizion privat, i cili e akuzonte znj. Nano se punonte për Asfalinë greke

**Enigmat**

## Hetimi që nisi nga një emision televiziv

**TIRANE**

Ka apo nuk ka një dosje të Xhoana Nanos në skutat e shërbimit sekret shqiptar? Një pyetje që lindi pikërisht pas njërit prej emisioneve televizive të kohës, ku mundohej të hidhej dritë mbi jetën private të bashkëshortes së re të Fatos Nanos, në kulmin e përplasjeve të mëdha politike brenda gjirit të socialisteve, para 24 korrikut 2002, për çështjen e Presidentit të ri të Republikes. Nano nuk ishte tërhequr asnjëherë nga një ide e tij, e bërë publike në një tjetër emision televiziv, atë "Opinion" në TV Klan më 18 tetor 2001. Një përplasje mes përkrahësve të kryesocialistit dhe kundërshtarëve të tij, të ndihmuar edhe nga përkrahësit e idesë se një mandati të dytë për Presidentin e atëhershëm Meidani. Në atë kohe, u përfol shumë se shefi i shërbimit sekret Fatos Klosi, mbështeste kandidaturën e Meidanit. Dhe për t'ia arritur kësaj, u tha se po përdorte disa mekanizma, njëra prej të cilave, mund të ishte edhe bërja publike e jetës private të Xhoanës, sidomos gjatë kohës që ajo jetonte në Greqi e punësuar në një agjensi udhëtimesh mes Athines e Tiranës. Një ndërmarrje e guximshme, ku lihej të kuptohej se ajo kishte patur një raport të erret me një ish-punonjës të shërbimeve sekrete greke, (Asfalia) para lidhjes serioze me Nanon, të bërë publike në atë kohë.



Petrit Myftari

Por pas kësaj gjërat rrodhen ndryshe, ku Nano pasi zgjodhi me Berishën Presidentin konsensual, u bë Kryeministër dhe një nga vendimet e tij të parë që firmosi, ishte shkarkimi i Klosit nga kreu i SHISH. Para emisionit televiziv Nano dhe Klosi i kishin përmirësuar raportet e vështira, madje ishin parë të drekonin gjatë, në një nga restorantet luksoze të Tiranës.

## Grupi i PS: Solidaritet Edi Rama mbledh shtabin në Tiranë

Grupi parlamentar u PS, në mbledhjen me dyer të mbyllura është marrë më tepër me punën që duhet të bëjnë deputetët në përbërje të grupeve të punës sipas zonave përkatëse, për fillimin e punës për zgjedhjet parlamentare të vitit të ardhshëm. Në këtë mbledhje është diskutuar në lidhje me shmangjen e debateve dhe të "intrigave" mes deputetëve socialistë, për t'i lënë vendin një solidariteti të nevojshëm për një fitore të thellë në zgjedhjet parlamentare dhe krijimin e besimit tek votuesit për ardhjen e PS në pushtet. Njëherësh kreu socialist Rama ka kërkuar që të nisin menjëherë takimet në elektorat, ndërsa është diskutuar skema që do të përdoret për të sqaruar qytetarët se përsë Berisha duhet të largohet nga pushteti, cilat janë abuzimet e tij me pushtetin, si do të binden qytetarët se programi qeverisës i PS është ai i duhuri për t'i dhënë fund rrënimit të Shqipërisë. Njëherësh është diskutuar dhe për punën që do të bëhet me listat, me organizimin e punës në terren. Dhe vetëm disa orë pas mbledhjes së grupit, në takim me Ramën kanë qënë deputetët eTiranës, anëtarët e asamblesë dhe të kryesisë së PS që janë të deleguar në Tiranë, duke startuar në këtë mënyrë në mënyrën më të mirë organizimi i punës me bazën.

### Kreu i PS për ndryshimet në Kushtetutë: Paketa jonë, pastaj imunitetin

# Rama: Pas 10 muajsh rrugë e re, ose rrënim me Saliun

*"Kryeprokurori me 3/5, iu referuam kushtetutave të Evropës"*



**Lajmi**

**Kreu i PS Edi Rama tha dje në mbledhjen e grupit parlamentar se pas 10 muajsh vendi do të jetë nën qeverisjen e një lidershipi të ri ose në rrënim me Sali Berishën. Ndërsa në lidhje me heqjen e imunitetit, Rama tha se duhet miratuar më parë paketa e PS.**



**TIRANE**

JAKIN MARENA

Ardhja e vjeshtës dhe afrimi i zgjedhjeve të përgjithshme elektorale ka bërë që Partia Socialiste të startojë me aksionin e saj politik, duke nisur me ekonominë. Kreu i PS gjatë mbledhjes së grupit parlamentar ka sulmuar ashpër qeverinë duke e akuzuar për rrënim të ekonomisë dhe varfërimin e qytetarëve shqiptarë. Numri një i socialistëve tha se axhenda politike e të majtëve gjatë këtyre muajve do fokusohet tek ekonomia, duke theksuar se rënia ekonomike në vend është e rëndë ndaj duhet një ndërhyrje e menjëhershme. "Në këto 10 muaj do fokusohemi tek ekonomia dhe nuk do mjaftohemi, duke reaguar se sa keq e ka katandisur qeveria. Zyrtarisht të punësuarit janë po aq sa ishin 7 vjet më parë. Sot gjysma e familjeve që kanë nevojë për ndihmë ekonomike nuk e marrin. Të dhënat e fundit tregojnë se më shumë se gjysma e shqiptarëve jetojnë në varfëri. E kemi thënë se fuqia blerëse vetëm bie, pasi për shkak rënia ekonomike është e vetmja rrugë e kësaj qeverie. Në këtë prag 100 vjetori, rritja e pagave minimale nuk kthehet në një faktor më të mirë, pasi nuk përkthehet në fuqi blerëse. Humbja e ekonomisë është e rëndë dhe ndërhyrja do të jetë e menjëhershme. Sulmi që i është bërë bizneseve me gjoba të mëdha janë përpjekje të një qeverie me probleme", deklaroi Rama.

Ai nënvizoi se është koha që opozita t'i japë fund rrënimit të ekonomisë, duke i dhënë rrugë alternativës së saj 'Për një rilindje shqiptare'. "Zgjedhja pas 10 muajsh është e qartë ose rrënim ose rrugë e re. Më një program të ri dhe lidership të ri", deklaroi Rama, duke shtuar se për këtë qëllim gjatë muajve në vijim opozita do të nisë turin e takimeve në çdo qytet për të të dialoguar dhe ndarë me shqiptarët çdo shqetësim. Njëherësh kreu i PS Rama ka ripërsëritur qëndrimin e PS-së, në lidhje me çështjen e kufizimit dhe heqjes së imunitetit të zyrtarëve të lartë. Rama duke theksuar se opozita është pro votimit në Kuvend, i bëri apel mazhorancës që të votojë më parë ndryshimet Kushtetuese të propozuara nga PS, të cilat sipas tij bazohen në Kushtetutat Europiane, ku u bazuan edhe për propozimin e zgjedhjes se kryeprokurorit te ri me 3/5 e votave të Kuvendit. "Kanë nisur punimet e Parlamentit dhe ne presim të nisë diskutimi për të gjitha ndryshimet Kushtetuese. Sa për imunitetin qeveria le ta vijojë dialogun e komunikimit me këmbë dhe duar të lidhura nga opozita. Ne kemi thënë se do e votojmë vetëm pas ndryshimeve. Do i thoja shqiptarëve të largojmë sa më parë një kryeministër që akuzon opozitën për cdo gjë që nuk bën vetë. Paketa jonë u etiketua si pacavure. Nuk është suprizë. Edhe për kryeprokurorin që të votohet nga 3/ 5 iu referuam Kushtetutave Europiane, për të cilat i referohemi edhe për paketën Kushtetuese", deklaroi Rama.

Njëherësh kreu socialist ka folur dhe për zgjedhjet, që sipas tij do të ndalin rrënimin dhe grabitjen e këtij vendi. "Të largojmë qeverinë me votë, qeverinë që kërkon ta cojë Shqipërinë në humnerën e pashmangshme siç është grabitja e zgjedhjve, për të cuar më pas në grabitjen e qytetarëve", tha Rama. Kreu i PS akuzoi qeverinë për mungesë programi emergjencash, si dhe turp që Shqipëria ende nuk ka një mjet ajror të dislokuar në vendet më të shfaqura ndaj rrezikut të zjarrit. Rama ka sulmuar qeverinë duke theksuar se vendi ynë ka numrin më lartë të të vrarëve dhe plagosurve sesa në Afganistan dhe Irak, ndërkohë që shëmbëlltyra e abuzimit shfaqet në pagën e guvernatorit të BSH.

### PAKETA E PROPOZIMEVE TË PS PËR NDRYSHIMET KUSHETETUESE

- Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
- Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti me pëlqimin e 3/5 të gjithë anëtarëve të Kuvendit"
- Gjyqtari i Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij, por në çdo rast jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i mandatit të tij.
- Procedura për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues paraardhës. Kuvendi duhet të marrë në shqyrtim dekretet e Presidentit dhe të shprehet me vendim për rrëzimin ose miratimin e tyre brenda 1 (një) muaji nga marrja e dekreteve.
- Anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti me pëlqimin e 3/5 të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Kuvendi duhet të marrë në shqyrtim dekretet e Presidentit dhe të shprehet me vendim për rrëzimin ose miratimin e tyre brenda 1 (një) muaji nga marrja e dekreteve.
- KLD përbëhet nga Presidenti, Kryetari i Gjykatës së Lartë, ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, si dhe 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për 5 vjet pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.
- Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti me pëlqimin e 3/5 të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi. Ai përzgjidhet nga radhët e juristëve me kualifikim e integritet të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.

## Berisha-Meta:

### "Imuniteti të hiqet me çdo kusht"



Nga Sllovenia, kryeministri Berisha nënvizoi se mazhoranca po bën çdo përpjekje për ta hequr imunitetin në Kuvend por s'përjashton mundësinë e referendumit, si zgjidhjen e duhur në rast se votimi në Kuvend dështon. Duke mbetur në këtë mënyrë në qëndrimin e tij të palëkundur për të miratuar imunitetin me referendum. Ndërkohë, aleati kryesor i mazhorancës, Ilir Meta, theksoi dje që nga Skrapari se politika duhet të bëjë gjithçka për marrjen e statusit kandidat në tetor. Sipas kreut të LSI-së, rruga më e shpejtë për heqjen e imunitetit është parlamenti. Imuniteti sipas Metës duhet të hiqet sa më shpejt, me çdo mjet demokratik, për të përmbushur në kohë kushtet e BE për marrjen e statusit kandidat. Një deklaratë ke konsideruar si tërheqje nga qëndrimi fillestar.

## Kukan: Referendumi do kohë, politika të marrë përgjegjësitë

**Kreu i delegacionit të Europës Juglindore në PE Eduard Kukan shprehet se referendumi kërkon kohë e politikanët duhet të marrin vetë përgjegjësitë. Deklarata vjen pas takimit me ministrin e Jashtëm Panariti në Bruksel. Ai tha se disa çështje është mirë të zgjidhen nga vetë politikanët. "Ju e dini se referendumi është demokraci e drejtëpërdrejtë. Kjo është gjë shumë e mirë. Por koha është shumë e rëndësishme tani. Që të bësh një referendum duhet shumë kohë. Mendoj se për disa çështje të rëndësishme të vendit, politikanët do ishte mirë që të marrin vetë ata përgjegjësi mbi vete. Pra, ata duhet ta marrin vetë përgjegjësinë, jo t'ia kalojnë popullit. Mendoj që në këtë situatë që ndodhet Shqipëria tani, është e nevojshme të gjenden rrugë e mundësi që të sjellin rezultate", tha Kukan. Realizimi i reformave, sidomos ai i heqjes së imunitetit të politikanëve e të gjyqtarëve si dhe rezultatet e dukshme për gjithë qytetaret kanë qenë objekt i takimit Panariti-Kukan. Heqja e imunitetit konsiderohet njëri nga kriteret politike të papërfunduara deri tani për mungesë të konsensusit. "Jemi të kenaqur me dialogun politik, por kjo s'mjafton. Kemi nevojë për rezultatet që dalin nga ky dialog", thotë Kukan.**



## Fyle-Haxhinastos:

# "Urgjent reformën parlamentare dhe antikorrupsionin"

■■■ TIRANE


Stefan Fyle

Komisioneri për Zgjerimin dhe Politikat e Fqinjësisë Europiane, Stefan Fyle, u takua me ministrin e Jashtëm Panariti, ku kanë diskutuar zhvillimet e fundit sa i përket procesit të integrimit evropian të Shqipërisë. Komisioneri Fyle përgëzoi përpjekjet e sinqerta të bëra nga qeveria e opozita për të forcuar bashkëpunimin në kontekstin e reformave institucionale dhe mirëpriti zhvillimet pozitive të arritura së fundmi. Ai iu referua veçanërisht miratimit konsensual të kodit elektoral të rishikuar si një hap i rëndësishëm, që e sjell marrëveshjen politike të nëntorit të vitit 2011 pranë implementimit të plotë.

Fyle nënvizoi se Shqipëria ka një perspektivë reale për progres në rrugën e integrimit evropian në vitin 2012, me kusht që vendi të plotësojë në një masë të mjaftueshme e me rezultate konkrete reformat në fushat kyçe. Komisioneri për zgjerimin nënvizoi se dialogu konstruktiv politik duhet të vazhdojë për plotësimin e reformës parlamentare për rregulloren e parlamentit, e vetmja çështje e mbetur ende në pritje për tu arritur sipas marrëveshjes politike të nëntorit. Ai theksoi po ashtu nevojën për të vazhduar progresin në përmbushjen e 12 prioriteteve kyçe të Opinionit të KE me një theks të veçantë në sundimin e ligjit, duke përfshirë progresin në vendosjen e një regjistri të fortë dhe të besueshëm në luftën kundër korrupsionit. Në këtë drejtim, komisioneri Fyle tregoi se rishikimi i imuniteteve do ishte një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur. Duke përsëritur angazhimin e Komisionit Europian dhe mbështetjen e plotë për Shqipërinë në këto përpjekje, Komisioneri e ftoi Shqipërinë të mbetet e fokusuar në reformat gjithëpërfshirëse, që janë të nevojshme në arritjen e objektivit kombëtar të integrimit evropian.

## Shqipëria dorëzon raportin në Bruksel, vlerësohet progresi

# Sannino: Arritjet janë ekstremisht pozitive

## *Bregu: Hapi i fundit është heqja e imunitetit*

■■■ TIRANE

JAKIN MARENA

Drejtori i Zgjerimit në KE, Sannino ka mbetur ekstremisht i mahnitur nga balanca dhe progresi i Shqipërisë që nga fundi i vitit të kaluar për realizimin e prioriteteve të BE nga qeveria dhe politika shqiptare. Kështu dje, qeveria shqiptare dorëzoi në Bruksel qëndrimin e saj të fundit mbi përmbushjen e masës kritike të 12 përparësive kyçe, duke marrë një vlerësim paraprak nga Komisioni Europian. "Që prej nëntorit, kur le të themi një frymë e re nisi të funksionojë në vend, e në të vërtetë kur shohim 12 prioritetet e se çfarë është zbatuar ndër ato 12 prioritete kyçe, balanca është ekstremisht e mirë, ekstremisht pozitive. Dhe jo vetëm qeveria, por të gjitha partitë, të gjithë aktorët politikë në vend, dhe shoqëria në tërësi mund të gëzohen për çfarë është arritur deri këtu", ka qënë deklarata e Stefano Sanninos, Drejtor i Përgjithshëm për Zgjerimin në KE. Pas votimit të disa ligjeve me 3/5, emërimit të Avokatit të Popullit e miratimit të reformës zgjedhore, vendi nuk ka mbyllur ende çështjen e rregullores së Parlamentit dhe atë të imuniteteve. Kjo e fundit zuri vendin kryesor edhe në debatin e organizuar nga Qendra e Politikave Europiane në Bruksel. "Ka disa alternativa në vend për të shtyrë përpara ligjin për heqjen e imunitetit. Siç e dini, mazhoranca ka propozuar edhe një referendum kombëtar, i cili po ashtu është një mjet demokratik në mënyrë që të vijohet përpara. Pra, unë nuk shoh ndonjë mosmarrëveshje. Ata e shohin në mënyra të ndryshme, por kjo nuk do të thotë se palët nuk janë të angazhuara për të luftuar korrupsionin, e për të vendosur masa më të rrepta për të kontrolluar më mirë", tha ministri i Jashtëm Panariti. "Tani ne nuk kemi më kohë të mjaftueshme t'i hyjmë debatit të ndryshimeve kushtetuese gjatë shtatorit. Heqja e imunitetit është diçka që po e mbajmë si propozim që prej vitit 2003. Ndërsa ndryshimet e tjera kushtetuese që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë mund të diskutohen më vonë", tha ministrja e Integrimit, Majlinda Bregu. "Dua të nënvizoj rolin e imunitetit, që edhe për ne është një element i rëndësishëm. Lufta ndaj korrupsionit është një nga fushat ku ne besojmë se nevojitet të bëhen përpjekje dhe kjo do të përbëjë me siguri një përpjekje në drejtimin e duhur. Nëse ne, me shpresë, shohim miratimin e këtij ligji në një mënyrë le të themi jo të sforcuar por me marrëveshje ndërmjet të gjitha forcave politike, atëherë kjo do të përbënte me siguri një hap të rëndësishëm përpara, e shoqëruar nga të gjitha gjërat e tjera që janë bërë por edhe nga përpjekjet që forcat politike po bëjnë në fusha të tjera", këmbëngul Sannino. Ndërsa Bregu nënvizoi se është me rëndësi shprehja e një vullneti madhor nga politikanët në një çështje për të cilën janë të gjithë dakord. "Dua të them që ky është titulli i pjesës së mbetur të detyrimeve deri në fund shtator", tha Bregu. KE, i cili ka nisur hartimin e raport-progresit, do marrë në shqyrtim të dhënat e fundit të dorëzuara nga qeveria shqiptare për t'i përfshirë në dokumentin që publikohet më 12 tetor.


Majlinda Bregu me drejtorin e Zgjerimit në KE, Sannino

### Svoboda

Panariti ka takuar dje shefin e grupit të socialistëve e të demokratëve në PE, Hanes Svoboda, me të cilin kanë ndarë të njejtin shqetësim për nevojën e dialogut politik që të arrihet marrja e statusit të vendit kandidat në vjeshtë të këtij viti.

TREVIS
TRAVEL & TOURS
Zbuloni magjinë e Las Palmas në Gran Canaria (Spanjë)
Çmimi: 770 Euro; Qëndrimi: 6 netë në hotel me tre yje në Las Palmas, 1 natë në Pisa (Itali) në datë: 4 -12 Tetor 2012
Tel: +355 4 5077086 Cel: +355 67 20 20 796 e-mail: trevis@live.com

KABINETI SALAJ
APARATE DËGJIMI
Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:
- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve,
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan
Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com

## PS, bursa studentëve nën 27 vjeç, aplikimi për dy programe

**Me nisjen e vitit të ri akademik 2012-2013, Sekretariati i Rinisë dhe Emigracionit të PS hap procesin e aplikimit për bursa në dy programe studimore: 20 bursa për programin Bachelor dhe 4 bursa për programin Master. Ky aplikim është i vlefshëm për të gjithë studentët, nën 27 vjeç, që janë anëtarë të FRESSH dhe PS dhe dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta për kualifikimin e mëtejshëm në shkenca sociale. Dokumentacioni që duhet dorëzuar për aplikim është si më poshtë: Formular që vërteton gjendjen ekonomike familjare, fotokopje e mesatares së vlerësimit akademik të ciklit të fundit shkollor të përfunduar, vertetim për kohën e angazhimit në parti e pjesëmarrjen në aktiitetet e saj (vërtetim nga kryetari i rrethit të PS). Dokumentet mund të postohen në adresën e PS ose kopjet e skanuara mund të dërgohen elektronikisht në adresën e emailit. Periudha kohore për aplikim, 4-20 shtator, ndërsa përgjigja mbi fituesit e bursave, më 27 shtator.**

### Anëtarja e kryesisë së PS: Skema e opozitës për fitore

# Gjermeni: Ja si do t'a mbrojmë votën

## *"Mazhoranca skenarë, ne derë më derë për votën"*



**Gjermeni**

"Përvoja e hidhur e zgjedhjeve të kaluara që në patëm, ka shumë gjasa të jetë dhe pjesë e skenarëve ta tanishëm të qeverisë për zgjedhjet e ardhshme. Nuk është e lehtë të përballësh me shtetin dhe me gjithë strukturat e tij".

TIRANE

JAKIN MARENA

*Lajmi*

**Anëtarja e kryesisë së PS, Eglantina Gjermeni shprehet në lidhje me aksionin politik të opozitës që do të sjellë fitoren në zgjedhjet e vitit të ardhshëm, skemën e organizimit nga qendra në bazë dhe punën për mbrojtjen e votës, që kërcënohet nga qeveria.**

Anëtarja e kryesisë së PS, Eglantina Gjermeni në intervistën për gazetën "Shqiptarja.com" flet për aksionin politik të opozitës.

**Shqipëria tashmë ka hyrë në vitin elektoral. Cilat janë përgatitjet e PS për zgjedhjet e ardhshme elektorale?**

Është e vërtetë që viti elektoral ka filluar edhe PS ka nisur punën për zgjedhjet e vitit 2013, punë të cilën po e intensifikon çdo ditë deri në këto zgjedhje. Pikërisht për këtë periudhë 10 mujore deri në zgjedhjet e 2013, PS ka një strategji të sajën, që është rezultat i punës përgatitore dhe konsultimeve me disa grupe pune. Partia Socialiste në këtë vit elektoral do ta zhvillojë luftën politike në disa drejtime, konkretisht: Në Kuvend përmes debateve, interpelancave, komisioneve hetimore, seancave dëgjimore, etj,; forcimin dhe zgjerimin e strukturave të PS; dialogimin me qytetarët anembanë Shqipërisë për programin e PS, mobilizimin e qytetarëve në mbështetjen e një alternative qeverisëse që do të rivendosë demokracinë në Shqipëri, etj.

**Një vijim i programit për "Rilindjen Shqiptare"...?**

Që prej 5 nëntorit të vitit të kaluar, në Kongresin e PS u shpalos programi politik i Partisë "Për një Rilindje Shqiptare". Nga ky moment e në vazhdimësi është punuar për kthimin e këtij programi në një program qeverisës. Grupet e punës pranë Asamblesë Kombëtare kanë mbledhur ekspertët më të mirë për çështje të ndryshme që prekin qytetarët shqiptarë duke hartuar një program real, që i përgjigjet nevojave të qytetarëve dhe që është i realizueshëm. Grupet e punës kanë realizuar diskutime me qytetarë e grupe të ndryshme interesi në të gjithë Shqipërinë. Marrja e mendimeve sugjerimeve nga këto takime e kanë pasuruar dhe përmirësuar këtë program, i cili shumë shpejt do të jetë finalizuar. Dialogu për të ardhmen me qytetarët në çdo cep të Shqipërisë do të jetë punë e përditshme e çdo anëtari të PS. Ne duam që qytetarët shqiptarë të bëhen pjesë e vizionit të PS dhe të gjejnë një alternative të një qeverisjeje të mirë tek programi i saj për një Rilindje Shqiptare. Nga ana tjetër, grupi parlamentar ka një program pune për sesionin e ri parlamentar, lidhur me të gjitha interpelancat, komisionet hetimore, mocionet, debatet apo seancat dëgjimore që do të realizohen gjatë këtij sesioni.

**Besoj që do ketë dhe organizim të FRESSH e FGS...?**

Organizimi i FRESSH dhe realizimi i ristrukturimit te Forumit të Gruas Socialiste janë elementë të forcimit organizativ të PS, paralelisht me shtimin e anëtarësisë dhe forcimin e strukturave të PS në gjithë vendin. Mendoj që këto që përmenda dhe elementë të tjerë, padyshim dhe kordinimi i të gjithë këtyre aspekteve të punës, janë pjesë e strategjisë së PS për të fituar zgjedhjet e vitit 2013. Mbi të gjitha këto që përmenda është ringjallja e besimit tek qytetarët shqiptarë për një të ardhme më të mirë për ta edhe fëmijët e tyre.



**"Qytetarët shqiptarë janë lodhur nga politika e fajësimit të opozitës për gjitçka që qeveria duhet të bëjë, aq sa hera herës ky fajësim duket edhe qesharak"**

**PS nuk ka reshtur dhe në muajt e verës akuzat ndaj qeverisë së Berishës. Eshtë një "provë gjenerale" për muajin shtator kur do të fillojë opozitarizmi i paralajmëruar?**

Në shoqëritë demokratike opozita është bashkëudhëtare jo në bashkëqeverisje, por në evidentimin e problematikave dhe programimin e një rruge më të mirë për zhvillimin e vendit. Opozita natyrisht do jetë pengesë për qeverinë nëse qeveria ka tjetër axhendë apo të tjera interesa nga ato të qytetarëve. Për këtë arsye, demokracitë funksionale i krijojnë opozitës mundësi reale për shprehjen e alternativave, i krijojnë mundësi reale realizimit të standarteve demokratike që ajo sjell apo dëshiron të vendosë. Ashtu siç edhe juve thatë në pyetjen tuaj, PS nuk ka rreshtur në akuzat ndaj qeverisë, sepse dhe bëmat e qeverisë kanë qenë vërtetë të tilla që jo vetëm opozita por dhe qytetarë, intelektualë e analistë kanë reaguar fort. Pyje të tëra që po digjen, kriminaliteti po rritet në përmasa të frikshme, vrasjet nga aksidentet apo vetëvrasjet, papunësia është në rritje, varfëria është rritur, krimi në familje po rritet, të gjitha këto kanë një emeruës të përbashkët: keqqeverisjen dhe paftësinë e qeverisë për t'i parandaluar apo trajtuar këto probleme. Reagimi i opozitës ka qenë e do mbetet i vazhdueshëm në mbrojtje të jetës së çdo qytetari, të interesave të të gjithë qytetarëve, interesat e të cilëve me sa duket shteti i ka lënë në fund të axhendës.

**Muaji shtator do të jetë i ngarkuar, ndërkohë që mazhoranca vijon akuzat se opozita po bllokon integrimin. Cilat do jenë lëvizjet opozitare në Kuvend dhe në publik për të qartësuar elektoratin?**

Keni të drejtë, muaji shtator duket se ka filluar i ngarkuar. Pritet që të diskutohet sërish heqja e imunitetit edhe i gjithë propozimi i PS-së për ndryshimet kushtetuese si dhe të diskutohen projektligje të rëndësishme në parlament. Ekziston mundësia edhe shansi që në varësi të diskutimeve dhe votimit të heqjes së imunitetit në Kuvend si dhe miratimit të të gjitha ndryshimeve kushtetuese që PS propozon, që Shqipëria të marrë statusin e vendit kandidat për në BE në tetor. Ajo që dua të theksoj është, atë çka edhe kolegë të tjerë nga PS e kanë theksuar vazhdimit, se heqja e imunitetit nuk është i vetmi kusht/kriter, nga i cili varet anëtarësimi i Shqipërisë në BE. Janë 12 rekomandimet e Opinionit të Komisonit Europian, për të cilat qeveria shqiptare duhet të raportojë edhe mbajë përgjegjësinë për (mos)realizimin e tyre. Përsa i përket përqasjes që maxhoranca ka zgjedhur duke akuzuar apo hedhur baltë mbi opozitën, mendoj që është përqasje jo konstruktive, e qëllimshme e që thjesht synon të heqë vëmendjen nga problemet akute ekonomike e sociale që shoqëria shqiptare po kalon. Besoj se qytetarët shqiptarë janë lodhur nga politika e fajësimit të opozitës për gjitçka që qeveria duhet të bëjë, aq sa hera herës ky fajësim duket edhe qesharak.

**Thuhet se PS i ka votat për të qeverisur por në momentin e fundit ia tjetërsojnë. Cila do jetë strategjia për ruajtjen e votës?**

Së pari, dua të shpreh keqardhjen time që edhe sot në vitin 2012, pas më shumë se 20 vitesh demokraci, e drejta e votës së lirë cënohet. Ne kërkojmë të heqim imunitetin, kërkojmë të anëtarësohemi në BE, duke dashur të përmbushim standardet që na kërkon Europa, dhe nuk plotësojmë atë më minimalen për qytetarët shqiptarë, votën e lirë dhe të fshehtë. Përvoja modeste personale e dy zgjedhjeve të kaluara, ato parlamentare të vitit 2009 dhe ato vendore të vitit 2011, më kanë mësuar se vetë qytetarët, anëtarët e PS, ne të gjithë mund edhe duhet ta mbrojmë votën tonë, se bëhet fjalë për ne dhe të ardhmen tonë. Padyshim që jemi ne të parët të cilët do ta mbrojmë votën e shenjtë të çdo qytetari/e dhe për këtë do të perfeksionojmë organizimin për çdo qendër votimi, në çdo qytet apo komunë. Shqiptarët meritojnë zgjedhje të lira, të ndershme e demokratike, meritojnë të votojnë në mënyrë të fshehtë e të lirë dhe t'u lexohet drejt vota e tyre. Përvoja e zgjedhjeve të kaluara në Njësinë 5 më ka mësuar se edhe përkushtimi e angazhimi i të gjithëve minimizon ndërhyrjet apo manipulimet.

**Majko është shprehur se po rrezikon që të përsëritet '96-ta nga ana e qeverisë për vjedhjen e votës. Mendoni se mund ta parandaloni këtë dhe pse Berisha po merr të gjitha institucionet?**

Kjo që tha zoti Majko është një shqetësim real i yni, por edhe i shumë qytetarëve. Jo rrallë na thonë "Ne jemi socialistë dhe votojmë për PS, po a do të na i ruani ju votat?". Qënia në opozitë, do të thotë të kesh mundësi të kufizuara, krahasuar me shtetin, që në rastin tonë ka edhe pushtetin, ose më mirë themi thuajse të gjitha pushtetet. Përvoja e hidhur e zgjedhjeve të kaluara që në patëm, ka shumë gjasa të jetë dhe pjesë e skenarëve ta tanishëm të qeverisë për zgjedhjet e ardhshme. Nuk është e lehtë të përballësh me shtetin dhe me gjithë strukturat e tij. Krahasuar me shtetin opozita ka fjalën e saj, angazhimin edhe përkushtimin e çdo qytetari/e që kërkon një shoqëri më të drejtë më demokratike, më njerëzore, më sociale. Organizimi i mirë edhe puna derë më derë me çdo qytetar, mendoj është përqasja më e mirë për të fituar në zgjedhjet e ardhshme. Mund t'ju duket pak idealiste, por unë besoj të idealizimi dhe fatmirëisht njoh e takoj shumë njerëz idealistë që kërkojnë ta ndërtojnë të ardhmen e tyre në Shqipëri e jo diku gjetkë.

## Ministri Noka me Zv.ambasadorin e SHBA: Ndihma juaj, e çmuar

**Ministri i Brendshëm Flamur Noka, priti në një vizitë kortezie zv/ambasadorin e SHBA në Tiranë, Henry V.Jardine. Noka, pasi i uroi suksese Jardine për detyrën e sapomarrë, si zv/ambasador në Tiranë, i shprehu paralelisht dhe vlerësimet për bashkëpunimin ekselnet të strukturave të Ministrisë së Brendshme me strukturat homologe të SHBA, por dhe ndihmën e çmuar që ekspertët e ShBA-së kanë dhënë në të gjithë sektorët e Ministrisë së Brendshme. Noka thkeksoi, ndër të tjera, se ndihma e dhënë, nëpërmjet nëpërmjet programeve ICITAP dhe EXBS, ka mundësuar që Shqipëria te jetë një vend i sigurtë, partner i besueshëm dhe me një sistem model në menaxhimin e kufijëve të saj, ku "për këtë një meritë të padiskutueshme kanë edhe SHBA-të". Ndërsa zv/ambasadori Jardine, shprehu besimin se klima e shkëlqyer e bashkëpunimit mes Ministrisë së Brendshme dhe të gjtha strukturave në varësi të saj do vijojë edhe në të ardhmen. Edhe ministri i Brendshëm Noka, e garanatoi Jardine për vijueshmërinë e padiskutueshme të bashkëpunimit, duke shprehur bindjen se gjithmonë do jetë e nevojëshme eksperinca dhe ekspertizën e specialistëve të SHBA.**

### Flet kryetari i grupit të PS, Gramoz Ruçi

# Koalicion me LSI, nëse largohet nga Sali Berisha

## *"Nishani më çoi sms për deputetin e PS"*

*Lajmi*

**Kryetari i grupit kuvendor socialist, Gramoz Ruçi është shprehur se vendimin për të bashkëpunuar PS-LSI e ka vetëm kjo e fundit. Ruçi është shprehur se LSI duhet të prish kualicionin me Berishën për të bashkëpunuar me PS, duke marrë parasysh edhe tkurrjen e qeverisjes.**

TIRANE

ILIR BABARAMO

Kryetari i grupit kuvendor socialist, Gramoz Ruçi ka komentuar situatën politike në vend, dhe në veçanti pikat më të nxehta të këtij sesioni. Ruçi i ka kthyer përgjigje edhe se si qëndron e vërteta e mesazhit që kabineti i Presidentit Nishani ja ka dërguar atij. Ai thekson gjatë intervistës se mund të bëjë kualicion me LSI, nëse ai largohet nga PD.

**Cili është qëndrimi i PS për imunitetin? Paketa juaj e propozimeve janë kusht për votën ndaj imunitetit apo janë dy gjëra të ndara?**

Nuk mund të flasim për kushte, problemi është më i madh se kaq. Kushtetua është guri themeltar i shtetit dhe nëse është bërë një gabim, të cilin ne e kemi pranuar, mënyra sesi u ndërhy dhe e krahasuar kjo tani me propozimin për të ndryshuar një nen të Kushtetutës, ashtu sikurse kemi thënë e deklaruar, ne kemi propozuar që ndërhyrjet në Kushtetutë janë të domosdoshme por duhet prekur në disa aspekte pasi ndryshimi i bërë pada dy vjetësh prishi një balancë.

**Çfarë balance?**

Balancën e institucioneve të pavarura. Prekja e nenit të presidentit natyrëshëm që prish balancat e tjera, kështu që propozimet tona janë pikërisht për të ruajtur këtë balancë, pra nuk janë as kushte as pengesë për imunitetin. Për imunitetin ne e kemi shprehur që jemi pro heqjes por kërkojmë nga kundërshtarët tanë politikë që të merren më parë ndryshimet kushtetuese të propzuara nga ne në mënyrë që të ruhet kjo balancë për të cilën fola.

**PD i cilësoi paçavure propozimet tuaja...**

Ishte gjëja që nuk duhet ta dëgjoja. Politikisht është një gafë për mua. Jam habitur për këtë deklaratë sepse propozimet e PS janë zgjidhje e problemeve të funksionit të organeve të drejtësisë. Ato janë fryt i një mendimi të tërhequr nga mjaft ekspertë dhe modele të marra nga kushtetutat e të gjithave vendeve të BE-së, nga ku përmend Gjermaninë, Francën, Italinë etj.

**Berisha thotë që klubi i miliarderëve të PS-së nuk i intereson heqja?**

E kundërta është e vërtetë. Korrupsionin nuk e bëjnë opozitarët por pushtetarët. Nëse Berisha vërtet do të ishte i interesuar për statusin kandidat ai do të pranonte heqjen e imunitetit më herët. Kam qenë dëshmitar në negociatat për Presidentin, ku Rama i ka kërkuar për një orë e gjysëm Berishës zgjedhjen e një presidenti konsensual, reformën parlamentare, reformën zgjedhore dhe heqjen e imunitetin. Këto kanë qenë katër kërkesat që Rama i parashtroi Berishës dhe e pesta ishte që këto çështje të mbyllen brenda qershorit. Dhe pasi tëmandej që Rama e Berisha të shkonin bashkë në Bruksel për të kërkuar marrjen e statusit. Të gjitha këto kërkesa, Berisha i refuzoi.

> **Nëse LSI sot është në qeverisje nuk bëhet fjalë për koalcion me të. Nëse LSI bie dakord që kjo qeverisje është rrudhur e ka dështuar atëhere ne jemi të gatshëm të bashkëpunojëm me këto forcë politike.**

**A do ta votoni heqjen e imunitetin?**

Ne e kemi deklaurar dhe unë po e përsëris që ne kërkojmë që ndërhyrja në kusthetutë të bëhet njëherë dhe vetëm njëherë.

**Pra o të gjitha o asnjë?**

Nuk e thashë këtë. Po them që klasa politike të ulet dhe të diskutojë propozimet.

**Ideja e referendumit?**

Është një marrëzi kushtetuese sepse nuk mund të realizohet. Rruga e thjeshtë e shkurtër dhe pa asnjë shpenzim është vetëm parlamenti. E gjitha kjo është një alibi për të fajësuar opozitën për mos marrjen e statusit kandidat e për t'i thënë popullit që na pengoi opozita. Milionerët e PS i kanë vënë ato para në kohën kur nuk ishin deputetë. Berisha ka 8 vjet në pushtet, nëse i ka vënë dikush me rrugë të pista këto lekë, ai ka gjithë mundësitë që ta faktojë këtë dhe t'ja bëjë të ditur opinionit publik. Nëse ka vullnet politik, paketa mund të miratohet brenda këtij muaji, ose maksimumi në javën e parë të tetorit.

**Si është e vërteta në lidhje me mungesën e opozitës në delegacionin e Nishanit në Kosovë? Në media u fol se ju është dërguar në celular një ftesë me sms**

Nuk kam patur asnjë ftesë zyrtare nga institucioni i Presidentit. Nuk e di nëse adoleshentët e sotëm bëjnë dashuri me sms por në moshën time dhe të nishanit të bëje dashuri me sms do të thoshte që të martoheshe me mbleseri. Unë jam martuar me dashuri, Nishani besoj gjithashtu. Kur flasësh për marrëdhënie serioze midis institucionit të presidentit dhe opozitës shqiptare sigurisht që ka një protokoll, ka një zyrë edhe ne si PS nuk kemi marrë asnjë ftesë nga presidenti shqiptar. Lidhur me sms unë jam politikani që unë nuk i preferoj por pëlqej komunikimin direkt. Unë nuk pëlqej komunikimin me sms. Lidhur me çështjen e deputetit të Kukësit edhe kjo është një spekulim.

**Cili ka qenë teksti i mesazhit?**

Z.ruci, presidenti do vjeë në kosovë ndhe kemi menduar që të çoni dhe ju një deputet të ps. Unë nuk e di sot e kësaj dite kush ma ka bërë këtë sms sepse edhe një qytetar i thjeshtë mund të dërgojë një sms dhe të më thotë që jam Bujar Nishani. Cilin sms duhet të besoj? ndaj ju thashë që ky nuk është një komunikim serioz. Por edhe sikur të kishte ardhur me ftesë zyrtare ky ishte një qëndrim politik. Nuk do merrnim pjesë në delegacion.

**A do ndryshojë marrëdhëniet e opozitës me presidentin nishani sikundër vepruat me Topin? Ju edhe atë e kundërshtuar në fillim**

Emërimet e Nishanit në KLD, në SHISH dhe ushtri kanë qenë tërësisht politike. Ajo që ne paralajmëruam po ndodh.

**Do merrni pjesë në procesin e dërgimit të kandidaturave për kryeprokurorin?**



Nuk e di nëse Nishani do konsultohet me partitë politike, me anëtarët e instiucioneve kushtete apo me konstitucionalistw por ne do të jemi gjithmonë të hapur për të bashkuëprnuar me insticuionin e presidentit

**Do t'i çoni emër?**

Nuk mund të hedh fall. Unë nuk e di nëse do organizojë konsulta. Madje edhe nëse organizon konsulta ai do të pranojë kandidaturë. Zgjedhja është atribut i prsidentit.

**Por LSI ka paralajmëruar se do të çojë kandidaturë?**

Të gjitha këto pikëptyjet i zgjidh një problem. Mirtaimi i ndryshimit të nenve të kushtetutës që ka propozuar PS. Nëse prokurori, anëtarë e gjykatave më të lartë të zgjidhen me shumicë të cilësuar, sigurisht që do të kemi produkt pozitiv.

**A ka tentativa për t'u afruar me LSI-në?**

Ne s'kemi bërë ndonjë tentativë për ta tërhequr nga qeveria por kemi bërë një tentativë vullnetmirë për të zgjedhur me konsensus presidentin, si në takimin inofrmal ashtu edhe në takimin formal. Ky ka qenë qëllimi i vetëm në negociatat që kemi zhvilluar në atë kohë me LSI.

**Ekziston mundësia që të ketë një afrim tjetër?**

Asnjëherë nuk kemi thënë jo. Pse duhet të them jo? Ne kemi qenë e do të vazhdojmë të jemi të hapur, ashtu sikundër ka thënë z.Rama por edhe unë, ne do të bashkohemi në koalicion me të gjithë ato forca politike që nuk janë dakord me këtë qeveri. Nëse LSI sot është në qeverisje nuk bëhet fjalë për koalicion me të. Nëse LSI bie dakord që kjo qeverisje është rrudhur e ka dështuar atëhere ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me këto forcë politike. Por sot kjo pyetje nuk ngelet për PS-në por për LSI-në. Ne peridoitishtk kemi thënë që nëse LSI ikën nga pushtet dhe i bashkohet aksionit politik të opozitës, pse jo.

**Edhe nëse kërkon 8-10 deputetë në tavolinë?**

Vetë kodi zgjedhor i ka zgjidhur këto problem. Do futesh dhe çdo parti e koalicionit do të marrë aq vota sa do ti japë sovrani.

Nuk është kështu. Ato janë grupe pune pranë kryetarit të partisë në funksion të mbledhjes së ardhshme të Kryesisë dhe Asamblesë Kombëtare.

**Me z.Nano çfarë po ndodh, flitet se do krijojë një parti?**

E drejtë e tij. Edhe unë e kam dëgjuar por më shumë i besoj kur gjërat materializohen. Ajo që unë do të nënvizoja është që gjëja e fundit që nuk do ta besoja është që çfarëdo lloj veprimi që do krijonte z.Nano të dëmonte aksionit opozitar për fitoren në 2013.

Koment

# Zhbërja, parullë apo projekt?



NGA PREÇ ZOGAJ

*vijon nga faqja 1*

...komshiut se sa të ndërtojë shtëpinë e tij. Edhe po të këtë diçka të vërtetë në këtë deformancë të natyrës njerëzore, politika nuk duhet kurrsesi ta përdorë. Por politika e ka përdorur, madje barbarisht, sidomos kur heronjtë e vetëpagëzuar të "drejtësisë dhe duarve të pastra" kanë qenë në opozitë. "Prishja", "zhbërja", "çmontimi", "konfiskimi", "shkrirja", "ndëshkimi"- janë fjalët më të përdorura nga opozitat përgjatë tranzicionit. Në vitin 1997 politikanët "më të fortë" të opozitës së atëhershme premtonin mes duatrokitjeve t'u kthenin kreditorëve paratë që ua kishte vjedhur qeveria. Shqiptarët e dinë si vazhdoi historia kur këta "të fortë" erdhën në pushtet. Jo para të vjedhura e të fshehura nuk rekuperuan, por edhe asetet që morën në administrim i shiten për dy lekë duke bërë pronarë me pasuritë e kreditorëve miqtë e tyre. Në vitet 2000-2001, mes ngazëllimit popullor, Berisha fliste për ruspa dhe ndëshkime ekzemplare të qeveritarëve të korruptuar. Në këtë hulli, duke e zbutur paksa tonin, në vitin 2005 ai fliste për zhbërje të kontratave mafioze me pasurinë kombëtare, deri në anullimin e privatizimit të Albtelekomit. Edhe kësaj historie i dihet vazhdimi.

Çfarë ndodh?Përse partia dhe lideri opozitar, rëndom e fusin në mill kur vine në pushte shpatën e drejtësisë dhe pastërtisë që kanë vringëlluar në opozitë? Arsyet janë komplekse, aq sa nuk e thua dot me bindje a është ky një kapitullim, apo një riformatim realist i betejës përballë realitetit të fakteve. Megjithatë praktika e këtyre viteve ka nxjerrë në pah disa prej ketyre arsyeve.

E para, antikorruposioni për opozitat tona është më shumë parullë e retorikë për konsum propagandistik se sa projekt. Kjo kuptohet qartë kur opozita përkatëse vjen në pushtet.

E dyta, partia apo lideri fitimtar konstatojnë se akuzat e tyre pa doganë në opozitë kanë qenë të sajuara ose të fryra . Si shembuj ilustrues mund të permendim akzuat që Berisha u ka pas berë disa ministrave të qeverisë Nano.

E treta, të shinjestruar për t'u kontrolluar e shbërë ia dalin të lyejne qeren e lidershipit të ri në pushtet, pra t'ja marrin anën me premtime e rushfete .Një shembull ilustrues mund të konsiderohet privatimi i Albetelekomit.




E katërta, edhe kur ka tentuar të shbëjë ndonjë kontratë të konsideruar mafioze-korruptive, qeveria ka ndeshur në murin e legjislacionit ndërkombëtar. Shembulli ilustrues është projekti i "trenit elektrik" Tiranë-Durrës, për anullimin e të cilit Shqipëria është dënuar nga gjykata e Parisit dhe po paguan sa frengu pulën, me taksat e qytetarëve shqiptarë.

E pesta, - dhe kjo arsye me duket se zë pjesën kryesore në spektrin e arsyeve-, ekzsiton një qasje oportuniste, si një marrëveshje e pashkruar, mes opozitës dhe qeverisë, që e para t'i bjerë me top dhe e dyta të mos bëjë asgjë dhe kështu pambarim duke folur e folur, duke u pasuruar e pasuruar pa i hyrë askujt gjemb në këmbë.

Në lidhjen e tyre, këto arsye që mund të shtohen edhe më të tjera , kanë bërë që antikorrupsini të jetë kryesisht demagogji populiste në opozitë dhe hipokrizi në pushtet.

Publiku diçka ka mësuar patjetër përgjatë këtyre viteve se çfarë është demagogjike dhe çfarë është realiste në premtimet e opozitës në këtë pikë. Opozita e sotme duhet t'i bëjë llogaritë me një publik të mashtruar shpesh në të kaluarën. Zgjidhjet e propozuara duhet të jenë konkrete dhe në drejtimin e duhur. Sa më pak fjalë, sa më shumë zgjidhje ligjore dhe garanci të tjera që lidhen me ndershmërinë dhe kompetencën e ekipeve. Multimilarderi Gjorgj Soros, i njohur dhe i afishuar hapur si spekulant, ka shkruar një sentencë lapidare për këtë çeshtje në një prej librve të tij. Ai thotë se nuk ua kam frikën atyre politkanëve që perbetohen ditë për ditë se do t'i varin në shtyllat e rrugës spekullatorët dhe të korruptuarit. Unë ua kam frikën rregullave që mbyllin shtigjet e spekullimit.

Për të qenë e besueshme nga opozita e sotme pritet një projekt propozimesh ligjore qoftë për frenimin, qoftë për shbërjen e aferave korruptive. Projektit mund t'i besohet. Ekipit mund t'i besohet. A ka vend për zhbërje? Ka shumë, sidomos në sferën e tokave dhe trojeve. Janë mijëra e mijëra hektarë të rrëmbyer kaçakçe. Që nuk mund të rekuperohen kaçakçe, por në bazë të një projekti konkret, trasparent, demokratik. Nga e tjetër opozitarët duhet të jenë konkretë e të saktë kur flasin për zhbërje. Kot që i dalin në shteg Berishës , duke i dhënë dhënë rast të spekullojë, duke futur në listat e "zhberjes" edhe asete që opozita nuk i ka fare në mendje. Hidrocentralet e vegjël, përshembull, apo liçensat e energjisë së rinovueshme , janë produkt i një strategjie pozitive për shfrytëzimin e resurseve natyrore të vendit. Opozitës i shkon të mbështetesë hapur përpjekjet e mëdha të firmave dhe operatorëve për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël, duke ofruar, po të ketë mundësi, rrugë të reja neser për financimin e tyre. Ndërsa për liçensat e energjisë se erës pyetja për t'u shtruar është përse nuk po fillojnë dhe çdo të bëjë opozita nesër për të mundësuar fillimin e investimeve. Kjo është fusha tipike ku zhbërja duhet zevendësuar menjëherë me bërje. Më bërjen që është kryefjala e një opozitë të re.



## Debate në komisionin e Ligjeve, PS 'kundër' kalendarit të punës

**Shqyrtimi i projekt ligjit për Gjykatën e Lartë duhet të shtyhet pas datës 10 shtator, që është parashikuar në kalendarin e punimeve të komisionit të ligjeve. Seanca e parë në këtë komision ka nisur me debate mes mazhorancës edhe opozitës. Nënkryetari i Komisionit të Ligjeve, deputeti socialist Fatmir Xhafaj, kërkoi shtyrjen e shqyrtimit të projektligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë. "Meqë amendamentet tona kanë lidhje drejtpërsëdrejti me ligjin "Për Gjykatën e Lartë" mendoj që kjo të shtyhet pak në kohë sa të fillojë ky proces", u shpreh deputeti Xhafaj për mediat. Nga ana tjetër, kryetari i Komisionit të Ligjeve, Ilir Rusmajli e kundërshtoi propozimin e PS-së, duke thënë se Konferenca e Kryetarëve e ka përcaktuar kalendarin për Këshillin e Legjislacionit dhe komisionin e Ligjeve për amendamentet kushtetuese. "Konferenca përcaktoi shqyrtimin e pr/ligjit "Për Gjykatën e Lartë" në seancën plenare të ditës së enjte më datë 13 shtator, që do të thotë se jemi të detyruar t'i bindemi Konferencës dhe ky pr/ligj do të trajtohet ose të hënën ose të martën në komision.**

### Ndryshohet projekti i rrugës Levan- Tepelenë, përmbytej nga hidrocentrali

# Levan-Tepelenë, edhe 12 mln

Miratohen ndryshimet në marrëveshjen për rrugën Fier-Tepelenë. 12 milonë euro shtesë për të përfunduar rrugën e nisur që në vitin 2006. Shkak hidrocentrali i Kalivaçit

### *Lajmi*

**Konçensionari që ka marrë hidrocentralin e Kalivaçit ka sjellë pengesë për përfundimin e rrugës Levan-Tepelenë. Përmbytja e kësaj zone, prej këtij objekti, ka sjellë që qeveria të kërkojë sërish 12 milionë euro shtesë. Megjithatë ministria e Transportit shprehet se do të lidhet një marrëveshje për të dëmshpërblyer devijimin e rrugës.**



TIRANE

Fernada Cenko

Mbajtja pezull e punimeve në rrugën Fier-Tepelenë, punimet për të cilën kanë nisur që në vitin 2005 kanë shërbyer për debate të ashpra në Komisionin e Ekonomisë. Pasi janë njohur me kërkesën e Ministrisë së Transporteve për një borxh shtesë në lidhje rreth 12 milionë euro për ndërtimin e kësaj rruge detutetët e Partisë Socialiste kanë kërkuar shpjegime në lidhje me koston e deri tanishme dhe fazën në të cilën ndodhen punimet. Deputeti i Partisë Socialiste Arben Ahmetaj kërkoi shpjegime në lidhje koston e përgjithshme të ndërtimit të rrugës, dhe volumin e punimeve që janë kthyer deri tani. Nëndrejtori i rrugëve Ylli Gjoni pranoi faktin se punimet në këtë rrugë kanë nisur 6 vjet më parë dhe shkak për zvarritjen e punimeve sipas tij nuk ka qenë mungesa e fondit, pasi borxhi nga banka Investimeve është marrë që në kohën e nënshkrimit të kontratës, por shkak për zvarritjen është ndërtimi në atë zonë i hidrocentralitë të Kalivaçit. "Kini parasysh ka pasur një diskordancë të madhe me projektin e rrugës dhe me projektin e Kalivaçit. Ky i fundit si projekt parashikonte një kuotë të rezervuarit, e cila konfliktonte me kuotën e rrugës. Pra në momentin që do ndërtohej hidrocentrali një pjesë e mirë e rrugës do të përmbytej sipas projektit original. Jemi detyruar që të ndryshojmë projektin e rrugës por nuk është ekzekutuar ende pasi ne gjykojmë që kjo i takon konçesionarit për t'u bërë pra nuk i takon fondit të investimit të publikut. Kjo është rreth 4.5 kilometra, kuota rritet me 5 metra dhe fatura shtesë është 12 milionë euro. Kjo nuk i takon invesimti publik por konceisonarit", është shprehur Gjoni. Debati është transferuar në marrëdhëniet financiare mes qeverisë së dhe biznesit. Sipas deputetëve socialistë kosot shtesë për ndërtimin e rrugës duhet të paguhen nga kompania koncencionare, e cila duhet të subvencionojë devijimin e segmentit.

### SHIFRAT

Deputetët socialistë e argumentojnë kërkesën e tyre me faktin se për shkak të interesave të koncencionarit është ndryshuar edhe projekti, e për rrjedhorë është shtuar edhe kostoja. "Kini parasysh ka pasur një diskordancë të madhe me projektin e rrugës dhe me projektin e Kalivaçit. Ky i fundit si projekt parashikonte një kuotë të rezervuarit, e cila konfliktonte me kuotën e rrugës. Pra në momentin që do ndërtohej hidrocentrali një pjesë e mirë e rrugës do të përmbytej sipas projektit original. Jemi detyruar që të ndryshojmë projektin e rrugës por nuk është ekzekutuar ende pasi ne gjykojmë që kjo i takon konçesionarit për t'u bërë pra nuk i takon fondit të investimit të publikut. Kjo është rreth 4.5 kilometra, kuota rritet me 5 metra dhe fatura shtesë është 12 milionë euro. Kjo nuk i takon invesimti publik por konceisonarit", tha Ylli. I pyetur nga deputeti socialist Erjon Barçe, se sa lekë ka dhënë koncesionari, Gjoni u përgjigj se "Kjo është një kosto që i takon konscesionarit dhe do të zbatohet me marrëveshje. Është projekti gati dhe mbetet vetëm të zbatohet. Ka një kontratë që konceisonari duhet të marrë përsipër dëmin që i shkakton të tretëve dhe në këtë rast të tretët jemi ne". Ndërtimi i rrugës Fier-Tepelenë kërkon një investim shtesë prej 12 milionë eurosh, të cilat duhet të mbulohen nga buxheti i shtetit. Kjo shumë shtesë për të përfunduar, në muajin nëntor, rruga Levan - Tepelenë ka marrë votat e opozitës dhe të mazhorancës në komisionin e Ekonomisë.

## Pagesa

## Rruga Levan-Vlorë përfundon me 18 milonë euro shtesë

TIRANE

Pas 8 viteve vonesë, të shkaktuara jo vetëm nga mungesa e financimeve, por edhe nga problematika që lidhen me projektin dhe kompanitë nënkontraktore, rruga e re Levan-Vlorë përfundoj. Prej pak kohësh, kjo autostradë është bërë e kalueshme, edhe pse qarkullimi i automjeteve për momentin është i mundur vetëm në njërin krah të saj. Deri tani, sipas Ministrisë së Transporteve, rruga ka përfunduar në masën 100 për qind. Me shtesën 18 milionë euro, kostoja totale e rrugës arrin vlerën 60 milionë euro. Shtesa e fundit e fondeve duket se është një pagesë e prapambetur e punimeve të kryera, për faktin se një pjesë e mirë e zërave të projektit janë realizuar tashmë. Nga shtesa 18 milionë euro, 2 milionë do të shkojnë për investimin teknologjik që shërben për mbrojtjen e ekosistemit, një kosto kjo e barabartë më vendosjen e shtresës së stabilizantit që ndikon në rritjen e jetëgjatësisë së rrugës. Një ndryshim tjetër që ka ndodhur në projekt ka qenë edhe ai për rritjen e lartësisë së urave.



Rruga Levan-Vlorë

### ? PYETJE PERGJIGJE

**Kur është nisur rruga Levan Tepelenë?**
Marrëveshja financiare për ndërtimin e rrugës Levan-Tepelene është nënshkruar dhe depozituar në Kuvend në qershor 2005. Kryeministri Berisha anuloi ndërtimin e kësaj rruge dhe bllokoi miratimin e marrëveshjes. BERZH dhe BEI, financuesit e paketës së zhvillimit "Levan-Vlorë, Levan-Tepelenë, By Pass Fier", bllokuan financimin e dy akseve të tjera me kusht miratimin e marreveshjes për Levan-Tepelenë. Kryeministri Berisha pas 2 vitesh, në Maj 2007 lejoi miratimin e marreveshjes financiare në Kuvend.

**Po më pas?**
Në nëntor 2008, Berisha përfundoi procedurat e prokurimit për dy lotë të rrugës. Sali Berisha zgjodhi kompaninë Todini për njërin Lot, Alpine për Lotin tjetër. Pasi filloi punë në këtë aks, kryeministri Berisha premtoi se kjo rrugë do të përfundonte në vitin 2011.

**Po tani?**
Sot kësaj rruge i ka ngelur edhe 25 për qind. Asfaltimi i saj ka përfunduar deri në Memaliaj, ndërsa ngelet që deri në fund të nëntorit të përfundoj edhe Memaliaj-Tepelenë.

### REAGON BRAÇE

## Berisha po hakmerret me Shqipërinë e Jugut

**Rruga Levan Tepelenë dhe zvarritja për ta përfunduar atë që është nisur që në vitin 2005, ka nxitur sërish deputeti i Partisë Socialiste Erjon Braçe të reagojë për dëm kolosal që i kushton taksapaguesve shqiptarë. Braçja që në titull është shprehur se Berisha po hakmerret me Shqipërinë e Jugut. “Hakmarrja 7-vjeçare e Berishës ndaj Fierit, Ballshit, Tepelenes, Gjirokastres, Sarandes! Marrëveshja financiare për ndërtimin e rrugës Levan-Tepelene është nënshkruar dhe depozituar në Kuvend në Qershor 2005. Sali Berisha, kryeministër atë kohë, anulloi ndërtimin e kësaj rruge dhe bllokoi miratimin e marrëveshjes. BERZH dhe BEI, financuesit e paketës së zhvillimit "Levan-Vlorë, Levan-Tepelenë, By Pass Fier", bllokuan financimin e dy akseve të tjera me kusht miratimin e marreveshjes për Levan-Tepelenë. Në nëntor 2008, Berisha përfundoi procedurat e prokurimit për dy lotë të rrugës. Nga ky lot, pra nga 30 kilometra. 4.5 kilometra nuk jane nisur fare, madje do i lihen në dorë koncesionarit të hidrocentralit të Kalivacit për tu bërë. Është koncesionari që ka 9 vjet që nuk po bën hidrocentralin, imagjinoni rrugën. 8 kilometra, nga Memaliaj në Tepelenë nuk janë bërë fare”, është shprehur Braçe.**

## Braçe vijon akuzat për shpërdorim fondesh ndaj Fullanit

Kanë vijuar edhe gjatë ditës së djeshme akuzat e deputetit të PS Erjon Braçe ndaj guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për shpërdorim të fondeve publike. Duke iu referuar dokumentave zyrtare të BSH për vitet 2009-2012, ai paraqet në publik shpenzime të ndryshme të bëra nga guvernatori gjatë kohës së qendrimit të tij në këtë post. Në këto shpenzime bëjnë pjesë shpenzime për ushqim, 270 mijë dollarë në total; shpenzime për pritje, 305 mijë dollarë në total; shpenzime për telefoni (fikse e të lëvizshme, 766 mijë dollarë në total; shpenzime për ndriçim e ngrohje, 950 mijë dollarë në total; shpenzime për pastrim dhe higjenizim të Bankës, 322 mijë dollarë në total. Gjithashtu, ai pasqyron edhe shpenzimet për bileta avioni, treni, autobusi në masën 1.3 milionë USD, për udhëtime biznesi jashtë shtetit, 1.6 milionë USD, për viza e taksa doganore 155 mijë dollarë dhe shpenzime për dhurata 100 mijë dollarë. Ai fton qytetarët shqiptarë të mos lejojnë më tej që paratë e tyre t'u besohen zyrtarëve të tipit të Ardian Fullanit.

### Deri tani, kryeministri ka folur vetëm për "suksese"

# Sali Berisha pranon: Shqipëria, në krizë

## *Kërkohet ndihma e BERZH për sistemin bankar*

**Lajmi**

**Fjala "krizë", e cila deri tani nuk bënte pjesë në fjalorin e kryeministrit Berisha, ka zënë vend dje në fjalën e mbajtur prej tij në Slloveni, ku ka diskutuar për zhvillimin ekonomik ndërkombëtar. Ai ka folur vetëm për faktorë të jashtëm që kanë sjellë krizën në Shqipëri**

TIRANE

GENC KONDI




Kryeministri Berisha ka humbur tonet deri tani gjithnjë optimiste që e karakterizojnë kur bëhet fjalë për zhvillimin ekonomik të vendit, dhe mos ndikimin e kësaj sfera nga kriza ekonomike globale. Nga Sllovenia, ai për herë të parë foli dje me terma konkrete në lidhje me krizën dhe pasojat e saj në vendin tonë. "Ekonomia shqiptare natyrisht që i ka ndier pasojat e krizës ekonomike multidimensionale, e cila do të jetë, me sa duket, afatgjatë. Rënia e remitancave të emigrantëve, rënia e eksportit nga Italia, për shkak të krizës atje, problemet e krijuara nga euro në sistemin bankar, të gjitha të ardhura nga vendet anëtare të Eurozonës, kanë krijuar vështirësi reale", tha kryeministri.

Është hera e parë që Berisha përmend krizën që ka përfshirë vendin, por edhe këtë herë, duke e paraqitur atë si diçka të importuar nga jashtë. Deri tani, ai nuk ka pranuar as edhe një gjë të tillë, duke deklaruar se ekonomia shqiptare paraqitet me ritme të tilla rritjeje, që lihen pas vetëm nga vende si Gjermania dhe nuk ndikohet nga kriza botërore, falë reformave të ndërmarra me nismë të qeverisë.

**BANKAT**

Ndërkohë, ai ka kërkuar nga kreu i Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim Suma Chakrabart që të ndikojë për të shmangur një lloj penalizimi, që po ndihet në Shqipëri nga bankat e eurozonës. Kryeministri Berisha theksoi se kriza mbarë botërore ka shteruar kreditimet dhe i ka bërë bankat mëma evropiane e të tjera ndërkombëtare shumë hezituese e të shtrënguara. Ai u shpreh se penalizimi i vendeve si Shqipëria, që nuk është pjesë e eurozonës, por vuan efektet e politikave frenuese të bankave të eurozonës, mund e duhet të zbutet nga institucionet financiare si BERZH. Kohët e fundit, është vënë re se një numër bankash të pranishme në Shqipëri kanë rritur transferimin e kapitaleve jashtë saj, drejt bankave-mëm në Evropë. Kjo shifër, sipas Shoqatës shqiptare të Bankave, llogaritet në 209 milionë euro vetëm gjashtë muajt e parë të këtij viti.

**Investitorët**

## Sllovenët e "Mercator" largohen nga Shqipëria




Sllovenët e kompanisë "Mercator" kanë vendosur të braktisin tregun shqiptar, ku hynë pak vite më parë. Lajmin e bëri të ditur dje agjencia britanike e lajmeve Reuters. Gjigandi i supermarketeve pati operuar me një hipermarket në qendrën tregtare "City Park", në periferi të Tiranës, por, edhe pse hyri me shumë bujë në treg, ka vendosur të largohet për shkak të humbjeve. Sivjet "Mercator" ka ndërmend të dalë me fitim pas humbjeve të mëparshme ndaj synon që të shesë disa degë të saj, përfshi atë në Shqipëri, për të kompensuar humbjet. Lajmi është bërë i ditur në ditën kur kryeministri Sali Berisha, ka zhvilluar takime e biseda kushtuar ekonomisë në Slloveni, vend, me të cilin Shqipëria realizon shkëmbime të ulta tregtare, në shifrën e vetëm 200 mijë eurove në vit.

### Energjetika

# Qeveria shqiptare "gjobit" me 23 milionë euro CEZ Shpërndarje

TIRANE




Një gazetë e përditshme e Republikës Çeke vlerëson se tanimë Çekia dhe Shqipëria janë përfshirë në një luftë ligjore dhe politike sa i takon CEZ-it. Kompania e shpërndarjes së energjisë elektrike CEZ Shpërndarje njoftoi se administrata tatimore shqiptare i kërkon pagesë për TVSH dhe tatimfitimi në masën 23 milionë euro. Lajmin e konfirmon e përditshmja e Pragës "Lidove Noviny", duke iu referuar burimeve nga kompania-mëmë CEZ Group. Sipas gazetës, CEZ-it i kërkohet një absurditet: të paguajë nga arka e vet taksat për fatura, ku figuron furnizimi i kryer dhe TVSH-ja, por këto fatura nuk janë paguar nga klientët, pra nuk janë arkëtuar. Një numër i madh i këtyre klientëve, madje, janë ndërmarrje dhe institucione shtetërore.

Nga ana e saj, kompania çeke kërcënon me ndërprerjen e energjisë elektrike për ujësjellësit në Shqipëri. Gazeta citon menaxherët e CEZ-it që kanë thënë se "ne do të ndërpresim energjinë për kompanitë shtetërore, pasi detyrimi i tyre ndaj nesh me fatura të papaguara shkon në ekuivalentin e rreth 23.4 milionë dollarëve". Duke insistuar se biznesi në Shqipëri është shndërruar në ferr për CEZ-in, e përditshmja çeke kujton se as vizita në Tiranë e kryeministrit Petr Necas dhe ndërhyrja e Bankës Botërore nuk kanë ndihmuar për zgjidhjen e situatës. "CEZ absolutisht e kundërshton këtë trajtim" citon "Lidove Noviny" zëdhënësen e CEZ-it Barbora Pulpanova. Ndërkohë kompania çeke ka ndërmarrë një aksion për ndërprerjen e energjisë për ata që nuk paguajnë faturat. Sipas zëdhënëses masat ekstreme kanë bërë efekt dhe kanë rezultuar të suksesshme, ndërsa qeveria shqiptare ka paguar një pjesë të borxhit.

**LAJME SHKURT**

**Banka e Azerbajxhanit tërhiqet nga padia civile**

Ditën e djeshme duket se ka përfunduar çështja gjyqësore e filluar nga Banka Ndërkombëtare e Azerbajxhanit ndaj një grupi kompanish shqiptare e të huaja, rreth biznesmenit Rezart Taçi. Në seancën e parashikuar të zhvillohej ditën e djeshme, nuk është paraqitur askush si përfaqësues i palës paditëse, e cila më parë kishte kërkuar bllokimin e pasurive në masën 75 milionë euro. Burime nga Gjykata bënë të ditur se çështja duhet të këtë gjetur zgjidhje jashtëgjyqësore me mirëkuptim midis palëve.

**Albpetroli merr dy licensa të reja para shitjes**

Kompania shtetërore e naftës ka marrë dy licensa të reja pak ditë para se të përfundojë afati i dorëzimit të ofertave të blerësve të mundshëm, parashikuar më 7 shtator. Konkretisht, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë ka vendosur të liçensojë shoqërinë Albpetrol në aktivitetin e shpërndarjes te gazit natyror, për një afat 30-vjeçar. Po kështu, ajo ka marrë edhe licensën tjetër, të aktivitetit të transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, nga i njejti Bord.

**Jepen me koncension edhe shtatë hidrocentrale**

Qeveria shqiptare ka vendosur të japë me koncension shtatë hidrocentrale vendore, konkretisht ato në Qarr dhe Kaltanj, në rrjedhën e sipërme të Osumit, hidrocentralet Babjen dhe Lozhan 2 si dhe Kasollet e Selcës në rrjedhën e mesme të lumit Devoll, hidrocentralin Guri i Kuq në degët e lumit Osum, hidrocentralin Driza në ujërat e lumit Bistricë, hidrocentralin Potam në degën e lumit Pavllo dhe hidrocentralin Denas në lumin e Çemericës, njoftoi dje zëdhënësja e kryeministrit. Ajo shtoi se ka shkuar në më shumë se 320 numri i HEC-eve të dhëna deri tani me koncension.







### Ekspertët: Fitimi llogaritet të shkojë në 10 mln lekë në muaj

# Plehrat e Tiranës, si po lulëzon firma misterioze

### *Kompania forcon masat e sigurisë për punëtorët*

TIRANE

Esmeralda Keta

*vijon nga faqja 1*

... romëve, por duket se që prej asaj dite biznesi i grumbullimit të mbeturinave të ricikliueshme ka pësuar rritje të konsiderueshme. Siç edhe duket qartë edhe nga fotot që shoqërojnë këtë shkrim, tashmë kolitë e mëdha me plastikë dhe letër që bëhen gati për rciklim, kanë mbushur edhe rrugën kryesore që të çon drejt pikës misterioze të grumbullimit.

Kjo pasi, kjo pikë grumbullimi, është e vetmja që merr direkt të gjitha mbetjet që dalin nga Sharra. Banorët e komunitetit rom, por edhe ata që banojnë në këtë zonë tregojnë se gjatë gjithë ditës shikon kamionët që pasi mbushen me mbeturina të ricikliueshme nga vendgrumbullimi i Sharrës, dalin që aty dhe dhe shkojnë e shkarkohen në këtë pikën e re të grumbullimit, ku pasi ndahen sipas llojit, presohen, lidhen me dengje të mëdha dhe bëhen gati për t'u dërguar në fabrikat e riciklimit. Duke bërë kështu që kjo të jetë e vetmja pikë ku mblidhen mbeturinat e riciklueshme të të gjithë Tiranës. Dhe këtu bëhet fjalë për një biznes fitimprurës me miliona lekë. Ekspertët e fushës shpjegojnë se lënia në dorë vetëm të një biznesi të mbeturinave të riciklueshme, shpjegon fare qartë edhe gjuetinë ndaj romëve, pasi bëhet fjalë për një fitim që arrin në 10 milionë lekë të reja në muaj nga shitja e tyre. Ndërsa romët ishin bërë pengesë, pasi ata i mblidhnin që në kazanë dhe i çonin në pika të ndryshme. Ndërkohë që romët që punonin më parë, secili për llogari të vet, në vendgrumbullimin e Sharrës, kanë hequr dorë nga puna aty, pasi sipas tyre, pronari i ri që ka ardhur i paguan me një pagë fikse 800 lekë në ditë, ndërsa ata më parë mund të nxirrnin edhe 2000-2500 lekë në ditë. Por ndonëse u bënë disa muaj që ka nisur aktivitetin për grumbullimin e mbeturinave që krijon qyteti i Tiranës, misteri që mbulon firmën së cilës i është besuar ky biznes nuk është davaritur aspak. Përkundrazi. Duket se zotëruesit e kësaj kompanie, apo edhe ata u kanë dhënë lejen, po përpiqen në të gjitha mënyrat për ta mbajtur atë sa më të fshehtë. Jo vetëm duke mos dhënë asnjë detaj për emrin e firmës, statusin e saj, apo pronarin, por edhe rritur forcat e sigurisë që "patrullojnë" përgjatë gjithë këtij 1 km rrugë nga vendgrumbullimi i Sharrës deri tek pika e grumbullimit. Rojet nuk të lënë të regjistrosh asgjë, ndërsa kur u kërkon takim me drejtuesit apo përgjegjës, të thonë se nuk ndodhet njeri aty. Ata kanë përforcuar rregullat edhe për punëtorët, për të cilët kanë vënë në dispozicion autobuzë, me të cilët i marrin dhe i dërgojnë në shtëpi, duke shmangur çdo kontakt të mundëshëm me persona të tjera që s'kanë lidhje me biznesin e tyre. Në fakt ky biznes është denoncuar fillimisht dhe vazhdimisht nga këshilltari i majtë në këshillin bashkiak, Florian Pullazi, por duket se ai ka ngelur një zë i vetëm në këshillin bashkiak, pasi këshilltarët e tjerë të majtë, nuk kanë qenë shumë aktivë në këtë çështje. Por, pritet që gjatë ditës së nesërme, kur është edhe mbledhja e radhës e këshillit bashkiak, të majtët t'i kërkojnë llogari kreut të bashkisë Lulizm Basha për atë që po ndodh në Sharrë.



Pamje nga pika e grumbullimit të mbeturinave që është ndërtuar 1 km larg Sharrës

## "Avokati"

Në çështjen e dëbimit të romëve nga kazanët e mbeturinave të Tiranës, ndërhyri edhe "Avokati i Popullit", i cili i kërkoi bashkisë së Tiranës të heqë dorë nga kjo gjueti, ose të hartojë politika sociale për romët

### "NA HOQËN BUKËN E GOJËS"

Konfiskimi i kanoçeve apo materialeve të tjera të riciklueshme nga policët bashkiakë, ka nxiti reagime të ashpra në radhët e komunitetit rom. Ata kundërshtuan vendimin e bashkisë së kryeqytetit pasi mbledhja e kanoçeve është e vetmja mënyrë jetese, ajo që u siguron bukën e përditshme.

"S'mund të na ndalojnë të mbledhim kanoçe dhe plastiket, sepse ne prej atyre hamë bukë, mbajmë frymën gjallë. Kam dëgjuar që ne po pengohemi sepse Basha do që mbeturinat t'ia japë me koncesion një firme private që e ka kunati i tij. Jo vetëm që po na heqin bukën e gojës, por po përdorin dhunë ndaj nesh. Disa ditë më parë, policët bashkiakë ushtruan dhunë të rëndë fizike ndaj një fëmije", - protestonin romët.

## ? PYETJE PERGJIGJE

**■ Çfarë po ndodh me mbeturinat?**
Prej kohësh janë hedhur hije dyshime për firmën që i janë besuar të gjitha mbeturinat e Tiranës. Kjo pasi, askush nuk jep një përgjigje për emrin e firmës që po merret me ndarjen e mbeturinave të ricikllueshme, ndërsa ekspertët flasin për miliona lekë fitime në muaj.

**■ Po pse ka dyshime mbi firmën?**
Pak muaj më parë, policia bashkiake e Tiranës, nis një aksion ndaj romëve, duke i ndaluar të mblidhnin mbeturina në kazanët e plehrave të kryeqytetit. Kjo pasi firma që i ishte besuar Sharra, ankohej se nuk i shkonte asnjë mbeturinë dhe ajo s'kishte punë.

## Task-forca

### Antiduhani, lokalet "spiunojnë" njëri-tjetrin

Lajmërimi se do të ketë kontrolle në çdo lokal të kryeqytetit ka bërë që pronarët e tyre të marrin masa dhe të jenë kujdesshëm me klientët, të cilët mund të ndiznin cigare. Ndaj në 102 subjekte të kontrolluara në kryeqytet, brenda një dite, vetëm në 7 prej tyre u vendos masa e gjobës. Roland Shuperka, kreu i task-forcës që ka ndërmarrë këtë aksion, gjatë një konference për shtyp ka deklaruar se kanë pasur telefonata edhe nga pronarët e lokaleve, të cilët u thonë se ata kanë nisur zbatimin e ligjit, por u janë larguar klientët duke shkuar tek kafja përballë, pasi aty nuk i ndalon kush të pinë duhan. "Ne kemi vajtur, kemi bërë kontroll dhe na ka rezultuar e vërtetë. Sigurisht që kemi prerë fletën e gjobës", - ka shpjeguar Shuperka. Sipas tij, veç task-forcës, po punojnë për zbatimin e ligjit antiduhan me një regjim të ri pune dhe jashtë orarit zyrtar dhe inspektorët sanitarë të drejtorisë së shëndetit publik në Tiranë.



## Marrëveshja

# Droga në shkolla, policë për të kontrolluar nxënësit

TIRANE

Do të jetë një mësues dhe dy policë, të cilët do të shkojnë shkollë më shkollë në të gjithë vendin për të kontrolluar dhe sensibilizuar nxënësit e shkollave 9-vjeçare të mos përdorin drogën. Situata është parë me shqetësim ku sipas autoriteteve të arsimit, nxënës 12 dhe 13 vjeçarë janë përdorues të drogës.Për të arritur këtë ministria e Arsimit dhe Policia e Shtetit firmosën një marrëveshje bashkëpunimi. Drejtori i policisë së përgjithshme të shtetit, Hysni Burgaj dhe drejtori i arsimit parauniversitar në MASH, Fatmir Vejsiu tha se janë të vendosur për të nisur këtë program me qëllimin parandalimin e përdorimit të substancave të ndaluara. "Një pjesë e mirë e defekteve të treguesve për këto fenomene vjen nga puna e pamjaftueshme e familjeve të këtyre të rinjve. Aty ku ka familje të shëndosha, edhe rreziku i përdorimit dhe shpërndarjes së drogave dhe substancave të rrezikshme është më i vogël", - tha Skënder Uku, sekretar i përgjithshëm i MASH. Përveç drogës, adoleshentët të shkolla konsumojnë edhe alkool. Edhe në këtë rast, program i nisur konsiton në ndërgjegjësimin e tyre.






04 22 34 096 @ www.bankacredins.com

# Kush sjell një mik përfiton një thesar

- Përmes Depozitës Miqtë, JU përfitoni rritje të normës së interesit. Nëse sillni një mik të ri që të çelë një depozitë, JU dhe miku juaj do të keni një rritje të normës së interesit.
- Për të përfituar nga kjo ofertë, JU duhet patjetër të keni ose të çelni një depozitë me afat si dhe të sillni një mik të ri për të çelur një të tillë.
- Bonusi që ju përfitoni është 0.5% më shumë se normat e publikuara por në çdo rast norma e depozitës nuk mund të jetë më e lartë se 7% në monedhën lek, 4% në euro dhe 3% në dollarë.
- Depozita Miqtë ofrohet në afatet 6 mujore dhe 12 mujore.

*Depozita Miqtë është e vlefshme deri më datë 15 Shtator 2012*

CREDINS bank


DREJT SHKOLLËS NGA TEG
nga 29 GUSHT - 15 SHTATOR
Me blerje në TEG nga 29 gushti - 15shtator
Mund të FITONI:
Një LAPTOP dhe 5 Çmime
nga 10.000 lekë blerje
DHURATË në dyqanet e fëmijëve!
SHORTEU HIDHET NË DATAT 8 DHE 15 SHTATOR, ORA 19:30 PRANË HYRJES SË GJELBËRT!
KOLEKSIONI VJESHTË DIMËR KA MBERRITUR!
TEG
tirana east gate
OUTLET NË TEG!
4 DITË SUPER ULJE NË TEG!
6,7,8,9, SHTATOR
www.teg.al


VALË UHF
NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER
DIGITALB
TOKESORE
KANALI 42
Do na ndiqni në të gjithë Shqipërinë
DIGITALB
SATELITOR
KANALI 50
Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës
ABCOM
KANALI 158
Redaksia & Marketing
Rruga: "Dervish Hima",
Tre kullat, kulla e dytë, Tiranë
mobile: +355 69 60 60 421
marketing: +355 69 60 60 419
Studiot e prodhimit A1
Rruga: "Aleksandër Moisiu"
ish-Kinostudio Shqipëria Sot
TELEVIZIONI ME I RI
GATI ME NJE SUPER SEZON...
A1 REPORT!
origjina e lajmit...
Jemi një grup mediatik i pavarur nga çdo parti në të cilin rregullat profesionele të informacionit mbizotërojnë mbi luftërat politike
Lajmi në High Definition

## E zhdukura në Kukës, gjendet e mbytur në Fierzë nëna e 2 fëmijëve

**Kufoma e dekompozuar e nënës së tre fëmijëve u gjet dje në mëngjes në këmbët e urës së Kukësit. Thëllënza Rezmati ishte zhdukur tre muaj më parë nga banesa e saj në lagjen nr.5 të Kukësit dhe për 90 ditë nuk ishte mësuar asgjë rreth saj, vetëm dje, kur ujrat e shterruara të Liqenit të Fierzës dhe qarkullimi i një skafi i cili ka sjellë turbulence në ujë, ka bërë që të dalë mbi sipërfaqe trupi i pajetë i nënës së dy fëmijëve. Prapa kësaj ngjarjeje, qëndron një histori e dhimbshme pasi disa muaj më parë viktima kishte kryer një operacion në mitër dhe se mjekët kishin vendosur tia hiqnin atë. Nga frika se mos ishte prekur nga ndonjë sëmundje e rëndë, Rezmati ka hyrë në depresin gjë e cila solli dhe më pas marrjen e një vendimi ekstrem duke i dhënë fund jetës në liqenin e Fierzës. Hetimet e para flasin për një vetëmbytje të gruas në kushtet e një depresioni të lartë, ndërkohë që hetimet për këtë çështje tashmë do të pushohen, pasi ngjarja konsiderohet si e zbardhur nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda.**

### Nuk ekzsiston fakti, mungojnë procesverbalet e daljes

# Ditari i diktatorit akuza mbyll dosjen

### *Avokati:Presim argumentimin, do e kundërshtojmë*

**Lajmi**

**Dorëzohet prokuroria e Tiranës, lidhur me gjetjen e misterit të publikimit të ditarit personal të diktatorit Enver Hoxha.Pas disa muaj hetimi, prokuroria ka marrë vendimin për pushimin e hetimeve me argumentin e mungesës së faktit dhe munges së procesverbaleve të daljeve të materialeve historike nga arkivi qëndron i shtetit.**

TIRANE

ELTON QYNO

Në një kohë kur debati për dorëshkrimin e romanit mes Ismail Kadaresë dhe të vesë së dikatatorit Enver Hoxha, Nexhmie Hoxha, ka përfunduar në dyert e gjykatës së Tiranës, prokuroria e këtij rrethi ka pushuar hetimet lidhur me kallëzimin penal të bërë nga ana e Hoxhës, për publikimin e ditarit personal të bashkëshortit të saj. Vendimi për pushimin e hetimeve, është marrë pak ditë më parë, duke argumentuar se në këtë çështje nuk ekziston fakti dhe nisur nga kjo situatë, nuk mund të kërkohen përgjegjësit në rastin kur nuk ekziston fakti. Më tej në argumentimin që i bëjnë prokurorët mbylljes së hetimeve për këtë çështje, është se mungesa e faktit vjen edhe si rezultat i mungesës së proces verbaleve të daljeve të ditarit personal të diktatorit Enver Hoxha. Për të zbardhur pretendimet e Nexhmie Hoxhës, prokurorët e Tiranës kanë pyetur mbi 25 persona mes të cilëve edhe drejtoreshën e arkivit të shtetit Nevila Nika, por jo gazetarin Blendi Fevziu, i cili botoi në formën e një libri biografik ditarin e diktatorit Enver Hoxha. Nuk dihet me saktësi nëse mbrojtësit ligjorë të familjes së Nexhmie Hoxhës do ta ankimojnë në gjykatë vendimin e prokurorisë së Tiranës, por avokati i familjes Aranit Roshi është shprehur për gazetën "Shqiptarja.com" se sapo të njihen me vendimin e pushimit do vendosin nëse do i drejtohen me ankim gjykatës ose jo.

**PYETJA E DËSHMITARËVE**

Për gati gjashtë muaj me rradhë prokuroria e Tiranës ka pyetur mbi 25 persona, për të hedhur dritë mbi mënyrën e daljes nga arkivi të ditarit personal të Enver Hoxhës. Të gjithë personat e pyetur rreth këtij mesteri janë vërtitur në dëshminë e tyre, duke treguar procedurën e hyrjes së këtij ditari në arkiv, vitin, fondin ku rruhet si dhe mënyrën e dhënies tek personat e interesuar që studjojnë historinë, por dhe jo vetëm. Sipas deklarimeve te dëshmitarëve, mes të cilave edhe disa nga specialistet e arkivit, resturatoret si dhe drejtoreshësh Nevila Nikaj, ato kanë treguar se ky ditar nuk dihet se si ka dalë nga fondi i arkivit, duke shpjeguar vetëm procedurat e vënies në dispozicion të një dokumenti. Gjatë hetimit, nuk është pyetur për këtë çështje gazetari Blendi Fevziu, i cili me librin e tij biografik "Enver Hoxha" duket se u bë shkak që Nexhmie Hoxha ti drejtohet me një kallëzim prokurorisë së Tiranës, ku kanë kërkuar kryerjen e hetimeve për zbardhjen e plotë të misterit të zhdukjes nga arkiva i ditarit të Enver Hoxhës. Në kallëzim, e Nexhmie Hoxhës thuhet se pjesë nga ky ditar janë konstatuar të botuara në librin e Fevziut dhe në shtyp, gjë e cila sipas Nexhmies shton dyshimet për përgjegjësinë penale ndaj drejtuesve të arkivit qëndron.


Nexhmije Hoxha

**Libri**

Libri biografik "Enver Hoxha" sipas raportimeve të kohëve të fundit ka kaluar numrin e 50 mijë kopjeve të shitura. Në të tregohen një sërë dokumentash personale, në dikatorit Hoxha, por edhe qindra foto familjare të tij.

**REAGIMI I AVOKATIT**

Në një lidhje telefonike avokati i familjes Hoxha, Aranit Roshi është shprehur për gazetën "Shqiptarja.com" se edhe pse prokuroria e Tiranës ka marrë vendimin për shumin e hetimeve, ai por edhe anëtarët e tjerë të familjes Hoxha nuk janë njohur me vendimin zyrtar të organit të akuzës. Roshi ka nënvizuar se shumë shpejt ata do të njihen me vendimin e akuzës dhe se brenda 10 ditësh ata do marrin masa për një kundërshtim të mundshëm në gjykatën e Tiranës. Nuk dihet me saktësi nëse kundërshtimi i vendimit të prokurorisë do të kryhet ose jo, por avokati sqaron se pasi të jetë njohur me argumentimin e pushimit të hetimit për zhdukjen e ditarit, atëherë do vendosë për kundërshtimin ose jo të vendimit.

**FEVZIU BOTOI DILTARIN**

Dy specialistet e restaurimit kanë treguar në prokurori se për gati një muaj kishin punuar për të bërë restaurimin e disa parrullave politike dhe letrave personale të diktatorit Hoxha, por pas restaurimit sërisht dokumentat janë vënë në fondin e titulluar "Enver Hoxha". Gjatë dëshmisë së tyre, specialistet kanë pranuar se kohët e fundit kanë lexuar në librin biografik "Enver Hoxha" disa nga dokumentat e restauruara, por që në fakt ato janë vetëm një numër shumë i vogël dhe jo një ditar i plotë, siç dhe është botuar në këtë libër. Ajo që kanë këmbëngulur dy specialistet në dëshminë e tyre është se asnjë dokument i restauruar por dhe që ndodhet në fondin "Enven Hoxha", nuk kanë dalë jashtë arkivit.

**LAJME SHKURT**

**Zjarret, pranga dy çobanëve të armatosur**

Dy persona janë vënë në prangat e policisë pasi akuzohen se kanë djegur rreth 10 hektarë pyje. Personat e arrestuar janë Lin Marku 27-vjeç, banues në fshatin Gjobardhaj, të rrethit Lezhë dhe N. Ll., 15-vjeç, banues në fshatin Kaftallë, të rrethit Lezhë. Arrestimi u bë mbrëmjen e djeshme në orën 20:30, nga strukturat e seksionit kundër krimeve të rënda. Pas hetimeve të policisë, rezultoi se dy personat të cilët janë çobanë dhe kullotnin bagëtitë në mal, në vendin e quajtur fshati Terbun, i rrethit Pukë, i kanë vënë zjarrin asaj zone, duke shkaktuar djegien e 10 hektarë pyje. Gjatë arrestimit policia u ka sekuestruar dhe 2 armë zjarri automatike tip Kallashnikov, së bashku me një sasi fishekësh.

**Elbasan, 35-vjeçari vjedh ambulancën e spitalit**

Policia e Elbasanit arrestoi 35-vjeçarin Lavdim Kodra, i dyshuar si autor i vjedhjes së një autoambulance, një natë më parë. Sipas policisë, një autoambulancë tip Renault, me targa të Elbasanit 2951 C, pronë e spitalit rajonal "Xhaferr Kongoli", është vjedhur ndërsa ishte e parkuar në një rrugë në lagjen "Sul Paprri", pranë banesës së personit që punonte si shofer i mjetit. Pas konstatimit të vjedhjes së pazakontë, policia nisi hetimet duke arrestuar 35-vjeçarin Lavdim Kodra, si i dyshuar kryesor për ngjarjen.

### E pandehën fishekzjarr

# Kapsolli i granatës, plagos tre minorenët

TIRANE

Tre fëmijë të mitur kanë mbetur të plagosur në kombinat si rezultat i shpërthimit të një ndezësi granate. Ngjarja e rëndë ka ndodhur rreth orës 13:00 në periferi të zonës së kombinatit, ku dy kushërinjtë Arben dhe Fabian Xhepa së bashku me shokun e tyre Armando Merja të moshës 13 deri në 17-vjeç ishin duke luajtur me një kapsoll granate që e kishin gjendur në plehra. Teksa të miturit, i kanë vënë nga poshtë flakën e çakmakut me shpresën për ta shpërthyer, pasi pandehnin se kishin të bënin me një fishekëzjar, ata janë përballur me një shpërthim të fuqishëm duke i rrëzuar që të tre në tokë. Në momentin e shpërthimit tre fëmijët ndodheshin prapa murrit të një banesë ende të papërfunduar, ndërkohë që zhurma e kapsollit u dëgjua edhe nga banorët e zonës. Këta të fundit pasi kanë dëgjuar edhe thirjet e fëmijëve, kanë shkuar me shpejtësi në vendgjarje, ku kanë konstatuar se dy kushërinjtë Xhepa kanë marrë dëmtime në trup, ndërsa 17-vjeçari Armand Merja kishte dëmtime në sy. Kanë qënë banorët e zonës ata që i kanë transportuar me shpejtësi në Spitalin Ushtarak tre fëmijët e plagosur, ndërsa në vendgjarje kanë shkuar edhe efektivat e komisariatit në Kombinat. Për shkak të përcaktimit të lëndës plasëse në ndihmë të tyre kanë shkuar edhe specialistët e Drejtorisë së Policisë Tiranë, të cilët pas ekzaminimeve të kryera kanë dalë në përfundimin se lënda plasëse ishte një ndezës granate. Ndërkohë që janë pyetur edhe banorët e zonës, të cilët kanë pohuar se në momentin kur kanë dëgjuar shpërthimin kanë parë duke luajtur pranë disa ferrave, tre fëmijët e dëmtuar. Aktualisht tre të miturit ndodhen në spitalin Ushtarak, jashtë rrezikut për jetën, ndërkohë që sipas mjekëve dëmtime serioze në sy ka vetëm 17-vjeçari Armand Merja, i cili ka mbajtur dhe ndezësin e granatës. Nga ana e policisë ngjarja është konsideruar si aksidentale, ndërkohë që në zonën për rreth gjatë ditës së djeshme janë kryer kontrolle me dyshimin se në ferra ekzistojnë kapsollë të tjerë të hedhur.



## Masakra e Pukës, apeli rrikthen në detyrë shefin e komisariatit

Ish-shefi i komisariatit të Policisë Pukë, Ridvan Bushati është rikthyer në detyrë nga Gjykata e Apelit në Shkodër. Gjykata e Pukës kishte vendosur pezullimin paraprak të tij, për neglizhencë ndaj tragjedisë të ndodhur më 29 qershor të këtij viti në fshatin Mardhnac të Pukës, ku humbën jetën dy vëllezërit Markaj. Apeli në Shkodër pasi ka shqyrtuar dosjen në fjalë, me vendimin nr.157 të datës 03 shtator 2012 ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së rrethit Pukë të dhënë më 30 kobrrik 2012. Çështja u gjykua nga treshja e gjyqtarëve, Fuat Vjerdha kryetar dhe Astrit Kalaja e Luan Dervishi. Gjykata e Pukës në vendimin e saj të datës 30 korrik vendosi masën e pezullimit paraprak nga detyra ndaj Bushatit dhe 3 efektivëve të tjerë Lulzim Latifi, Kol Zaja dhe Qetësor Gurra. E gjithë çështja e ka zanafillën tek tragjedia në fshatin Mardhnac të Pukës, ku 3 vëllezërit Përmarkajt vranë dy vëllezërit Markaj në pritë, ndërsa mbetën të plagosur rëndë bashkëshortet e tyre Tone dhe Anxha Markaj si dhe nipi i dy viktimave. Ish-shefi i komisariatit u akuzua nga Avokati i Popullit se kishte dijeni për vrasjene dy vëllezërve dhe se nuk mori masa për të parandaluar krimin.

### Dëshmia e Agustin Kosit, 45-vjeçarit të kapur në Murriqan me 4.5 kg drogë

# "Heroinën e bleva 30 mijë euro"

### Akuza:I ndaluari pjesë e një grupi kriminal, droga u siguria në Tiranë. Gjykata, cakton masën e sigurisë "arrest me burg" për të arrestuarin, me banim në Zvicër

**Lajmi**

**I arrestuari me 4 kg heroinë dhe 500 gr kokainë, ka deklaruar në gjykatës se lëndën narkotike e kishte blerë 30 mijë euro, tek një person në Tiranë dhe se destinacioni i drogës ishte Zvicra. Pavarësisht kësaj dëshmie, prokuroria pohon se në këtë rast bëhet fjalë për një grup kriminal që trafikon drogë në vendet e evropës qëndrore.**



Heroina e kapur në doganën e Murriqanit

TIRANE

ELTON QYNO

Drogën e kam blerë në Tiranë kundrejt 30 mijë euro, por nuk jam në gjendje të arrij të jap shpjegime për të identifikuar personin që ma ka shitur, pasi atë unë nuk e njoh dhe se kujtoj dot". Kështu e ka nisur dëshminë e tij 45-vjeçari Agustin Kolsi që tre ditë më parë u ndalua në pikën kufitare të Muriqanit me katër kilogram lëndë narkotike heroinë dhe 500 gr kokainë. Gjatë ditës së djeshme, 45-vjeçari nga Lezha ka dalë para togave të zeza të Gjykatës së Krimeve të Rënda, ku është njohur me masën e sigurimit "arrest në burg" të kërkuar nga prokurori Njazi Seferi. Vetë i arrestuari që prej vitesh banonte si emigrant në Zvicër, ka pranuar autorësinë e krimit duke pohuar se ai kishte ideuar gjithçka vetëm, duke planifikuar që lëndën narkotike ta trafikonte në Zvicër ku dhe do e shiste në tregun vendas. Sipas dëshmisë së tij të dhënë në gjykatë, gjatë ditëve të muajit Gusht, ai ishte kthyer nga Zvicra në Shqipëri, ku do të qëndronte disa ditë me leje. "Gjatë pushimeve kam qëndruar disa herë në Tiranë, ku në një lokal teksa pije kafe më është afruar një person dhe më ka pohuar nëse isha i interesuar të blija heroinë. Këtij personi i jam prezantuar me emër të rremë, dhe kam përshtypjen se dhe ai më ka dhënë emrin e rremë, dhe jo të vërtetin. Pasi kam fol për disa minuta me të, kam vendosur të ble mallin kundrejt 30 mijë eurove"-ka treguar para gjykatës i arrestuari për trafik droge Agustin Kolsi.

#### DËSHMIA JO E SINQERTË

Nga hetimet e kryera nga ana e hetuesve të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, kanë lindur dyshime se 45-vjeçari është pjesë e një grupi të strukturuar kriminal që kryen trafikimin e lëndëve narkotike në vendet e evropës qëndrore. Kolsi prej disa vitesh banon në Zvicër dhe se nga verifikimet e kryera dhe kçyrja e telefonit të tij, ka rezultuar se thirja e fundit e tij ka qenë me një numër që mban prefiksin 044, që sipas burimeve të prokurorisë ky prefiks i përket shtetit të Zvicrës. Dyshimet e akuzës, flasin se grupi ka një strukturë, ku pas marrjes së lëndës narkotike në Shqipëri, personat pritës në Zvicër janë interesuar lidhur me vendodhjen e fundit të personin që kishte marrë përsipër të transportonte lëndën narkotike prej 4 kilogram heroinë dhe 500 gr kokainë. Gjatë marrjes në pyetje, 45-vjeçari ka pohuar se nuk ishte në gjëndje të punonte, prandaj dhe kishte vendosur të merrej me trafikimin e kësaj lënde narkotike, me qëllim sigurimin e një shume financiare. Kolsi është pyetur nga prokurorët edhe për identitetin e personit që i ka dhënë drogën si dhe vendodhjen e takimit, por për këtë të fundit ai ka dhënë një adresë, që sipas prokurorëve ka shumë gjasa qëtë jetë e rreme.

#### VENDIMI I GJYKATËS

Pas dëgjimit të dëshmisë së të arrestuarit Agustin Kolsi si dhe pretendimet e shfaqura gjatë seancës gjyqësore nga avokati mbrojtës i tij dhe prokurori i çështjes Njazi Seferi, Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur të lerë në masën e arrestit në burg të ndaluarin në pikën doganore të Murriqanit. Në vendimin e saj, gjykata argumentoi se 45-vjeçari është kapur në flagrancë me sasinë e drogës që kishte me vete, dhe nisur nga kjo situatë dispozitat ligjore parashikojnë caktimin e masës "arrest me burg" ndaj këtij të arrestuari. Në fakt kjo masë, sigurime është pranuar dhe nga vetë avokati mbrojtës, i cili deklaroi se çështjen në vijim do e ndjeki sipas dispozitave ligjore.

### Identifikohen autorët

# Lezhë vriten 17-vjeçari, plagoset shoku

TIRANE



Nuk kanë të ndalur vrasjet në vend, ku jo më larg se katër ditë nga ekzekutimi me armë i babë e bir në Shkodër, mbrëmjen e djeshme ka mbetur i vdekur me armë një 17-vjeçar ndërsa shoku i tij ka mbetur i plagosur rëndë. Ngjarja e rëndë është rregjistruar në orën 20:45 në Blinisht të Lezhës, ku një grup të rinj janë konfliktuar njëri me tjetrin, duke sjellë dhe përdorimin e armëve. Sipas drejtorit të policisë Lezhë Muharrem Furriku, shkaqet e kësaj vrasje janë banale, ku teksa autorët dhe të dëmtuarit ndodheshin në ambjentet e një lokali janë konfliktuar, duke bërë që të mbetet i vdekur shtetasi 17-vjeçar Danil Bardhoshi dhe i plagosur bashkëmoshatari i tij Valdo Marku. Këta dy persna janë qëlluar me armë zjari automatik, ndërsa pas kryerjes së krimit autorët janë larguar me shpejtësi për ti shpëtuar prangave të policisë së Lezhës. Drejtori i Policisë Lezhë, bëri me dije se tashmë autorët janë identifikuar dhe se gjatë mbrëmjes së djeshme efektivë të policisë kanë kryer dhjetëra kontrolle në zonë me qëllim arrestimin e autorëve të ktij krimi, që mendohet se janë dy persona. Nga pyetja e dëshmitarëve në vendin e ngjarjes policia e Lezhës ka mësuar se viktima dhe i plagosuri janë nga fshati Kallmet dhe se në momentin e ngjarjes ata ndodheshin në Blinisht. Pikërisht në këtë fshat, ata janë konfliktuar me disa të rinj të tjerë, duke bërë që sheri të degjenerojë deri në vrasje. Për zbardhjen e plotë të këtij krimi dhe administrimin në dosje të provave materiale në vendngjarje kanë shkuar dhjetëra specialsitë të policisë së Lezhës si dhe një prokuror i këtij rrethi. Kjo ngjarje e rëndë, vjen pas një ngjarjes të një pas një shme të ndodhura në vend, ku mbi dhjetë persona janë ekzekutuar me armë zjari gjatë muajit Gusht dhe ditëve të para të muajit Shtator.

## LAJME SHKURT

**Durrës, mbytet në det 86-vjeçaria nga Tirana**

Një grua në moshë të thyer ka humbur jetën në plazhin e Durrësit, policia e ka identifikuar atë si 86-vjeçaren Ksenofoni Lamani, lindur dhe banuese në qytetin e Tiranës. Ngjarja ka ndodhur në orën 19:00 të ditës së djeshme kur gruaja e moshuar e cila ishte bashkë me familjarë të saj, kishte hyrë në një moment në ujin e detit për t'u larë. Në rrethana të papritura, ajo është mbytur brenda në ujë, duke alarmuar familjarët dhe persona të tjerë që po pushonin në plazhin e Plepave në Durrës.

**Maqedoni, humb jetën 25-vjeçari nga Librazhdi**

Një person ka humbur jetën në kufirin me Maqedoninë. Viktima është identifikuar si Genci Halili, 25-vjeç nga fshati Rrajcë i Librazhdit. Mësohet se Halili ka qenë duke punuar në territorin e Maqedonisë, si punëtor sezonal. Ngjarja ka qenë aksidentale dhe Halili është goditur nga një pemë, teksa ka qenë duke punuar në prerjet e lëndës drusore. Genci Halili ka qenë duke punuar së bashku me vëllanë Erjon Halilin, edhe ky i plagosur rëndë nga goditja e pemës.

**Vrau xhaxhain, arrest me burg 26-vjeçarit**

Gjykata e Durrësit ka vendosur të lerë pas hekurave deri në zbardhjen e plotë të ngjarjes, 26-vjeçarin Endrit Dragoti, i cili akuzohet për vrasjen e kushëririt të tij, Tafil Dragoti 51-vjeç. Përcaktimi i masës së sigurisë "burg pa afat" erdhi pas kërkesës së Prokurorisë. Endrit Dragoti akuzohet se ka vrarë me thikë, nën efektin e alkoolit, kushëririn e tij, Tafil Dragoti. 51-vjeçari u gjet i vdekur në banesën e tij me fytin e prerë, mbrëmjen e së shtunës, tre ditë pas krimit të rëndë.

## Policët e doganës nën hetim, pinin në lokal kur "vidhej" dogana

Dy efektivë të policisë private janë marrë në përgjegjësi penale për akuzën e "Shpërdorimit të Detyrës", pasi rezultojnë se nuk kanë marrë masa për parandalimin e tentativës së vjedhjes së zyrës së financës në pikën doganore të Tiranës. Dy efektivat, quhen Petrit Milla dhe Kadri Koprencka, të cilët ditën kur ka ndodhur ngjarja kanë qënë me shërbim ruajtje të degës së doganës Tiranë. Sipas burimeve pranë policisë, dy personat e lartpërmendur nuk kanë arritur të parandalojnë tentativën e grabitjes, pasi dy policët privatë nuk kanë qënë prezent në vendin e shërbimit. Nisur nga kjo situatë, persona ende të paidentifikuar kanë arritur me mjete të forta të hapin një gropë në murrin e zyrës së financës, prej nga do të hynin për të grabitur kasafortën.Plani i tyre është rrëzuar pasi, siç duket janë pikasur nga kalimtarët e rastit gjë e cila ka bërë që ata të largohen menjëherë. Edhe pse grabitësit janë larguar, nga ana e efektivave të policisë private nuk është bërë asnjë denoncim në polici, pasi skanë konstatuar asnjë ndërhyrje në murrin rrethues, pasi kanë qëndruar në ambjentet e një lokali. Ka qënë njëra nga punonjëset e kësaj zyre, e cila ka bërë denoncimin në policinë e Tiranës

### Flet kreu i Dhomës Kombëtare të Avokatëve Maks Haxhia

# Avokatët mbi "binarë" dy pikat e penalizimit

### Haxhia: Trajnimet edhe për avokatët e vjetër



Maks Haxhia

**Lajmi**

**Ligji i ri për avokatinë që pritet të miratohet së shpejti në parlament, parashikon thjeshtësimin e procedurave për penalizimin e avokatëve mbrojtës në rastet kur ata nuk paraqiten në gjyq ose thyejnë etikën profesionale. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve ju është dhënë akses të drejpërdrejt ekzekutivit, gjyqsorit, sistemit akademik dhe publikut, në rastet e vendimeve penalizuese ndaj avokatëve, ndërkoshë që parashikohen trajnime të vazhdueshme për të gjithë avokatët, jo vetëm për fillestarët.**

TIRANE

Elton Qyno

Vënia në "binarë" të avokatëve që përfaqësojnë çështje të ndryshme në seancat gjyqësore duket se do të marrë jetë, pas miratimit në kuvend të propoziveme që ka bërë Dhoma Kombëtare e Avokatëve, propozime këto që tashmë kanë marrë "ok" edhe nga misionet ndërkombëtare që japin asistencën e tyre juridike në Shqipëri. Këto propozime janë miratur në një diskutim të datës 18 korrik, por tashmë ajo që mbetet është votimi në parlament. Sipas kreut të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Maks Haxhia, paketa e amendamenteve është fokusuar në dy probleme dhe njëkohësisht shqetsime që janë hasuar në veprimtarinë e përditshme të ushtrimit të profesionit të avokatëve. E para këto ndryshime janë fokusuar në thjeshtësimin e procedurave disiplinore ndaj avokatëve të cilët në mënyrë flagrante shkelin ligjin, statutin dhe Kodin e Etikës të profesionit të avokatit. Gjithashtu nëpërmjet këtyre ndryshimeve ju është dhënë akses të drejpërdrejt ekzekutivit, gjyqsorit, sistemit akademik dhe publikut të jetë pjesmarrës në procesin e vendimarrjes të masave ndaj avokatëve. Ndërsa si aspekt i dytë i rëndësishëm i parashikuar në këtë paketë ka të bëjë me procesin e trajnimit që Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet dhe ka për detyrë të trajnojë jo vetëm kandidatët për avokatë por edhe avokatët në detyrë, pra trajnimi fillestar dhe vazhdues.

**Zoti avokat, shumë shpejt do të rifillojnë sërisht diskutimet për ndryshimet në ligjin për funksionimin e avokatisë. Ju si kreu i dhomës kombëtare, keni paraqitur alternativat tuaja të ndryshimeve, cilat janë ato?**

Opinioni është ballafaqur me të drejtë apo edhe me manipulime me idenë se "avokatët janë shkaktarë të të gjithë situatës në sistemin e drejtësisë qoftë në nivelin vendimmarrjes ashtu edhe të ekzistencës së korrupsionit në drejtesi". Përball kësaj situate dhe këtij opinioni me ngarkesa me të drejtë apo pa të drejtë, ne në bashkpunim me një grup avokatësh nga Britania e madhe mbështetur nga fondacioni "Slim", si dhe në bashkpunim me "Usaid" dhe Ministrinë e Drejtësisë dhe misionin e Euralius, pas një periudhe përgatitjesh dhe debati të shumtë më së fundi u prodhua paketa e amendamenteve të cilat u miratuan dhe u kaluan për votim në Kuvend nga ana e Qeverisë. Ne si Dhomë Kombëtare e Avokatisë e kemi kapërxyer fazën e diskutimeve lidhur me këto amendamente, fazë e cila u kulmua në tavolinën e përbashkët me aktorët vendas dhe të huaj që përmenda më sipër dhe në finale në takimin e 18 korrikut u përpilua paketa në fjalë.Pra, nuk mund të flitet më për ekzistencën e alternativës tonë pasi, mesa jam njohur me paketën e ndryshimeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet faqes së tij në internet, kjo paketë është tërësisht ai produkt, i cili doli nga tavolina e rrumbullakët e muajit korrik. Duke përfituar nga rasti dua të shpreh mirnjohjen të komunitetit të avokatëve për bashkpunimin me Ministrinë e Drejtësisë natyrisht edhe për gadishmërinë dhe përkrahjen që qeveria u bashkua me shqetsimet tona shqetsime këto që në shumë aspekte përputhen me ato të opinionit dhe të ekzekutivit.

**Cilat janë obsjonet që shtrojnë avokatët për rastet kur ata mungojnë në seancat gjyqësore. Si mund të zgjidhet kjo situatë sipas jush?**

Kjo paketë amendamentesh është fokusuar në dy probleme dhe njëkohësisht shqetsime që janë hasuar në veprimtarine e përditshme të ushtrimit të profesionit të avokatëve. E para këto ndryshime janë fokusuar në thjeshtësimin e procedurave disiplinore ndaj avokatëve të cilët në mënyrë flagrante shkelin ligjin, statutin dhe Kodin e Etikës të profesionit të avokatit. Gjithashtu nëpërmjet këtyre ndryshimeve ju është dhënë akses të drejpërdrejt ekzekutivit, gjyqsorit, sistemit akademik dhe publikut të jetë pjesmarrës në procesin e vendimarrjes të masave ndaj avokatëve. Gjithashtu ju është dhënë hapsirë dhe garanci avokatëve ndaj të cilëve do të aplikohen masa që të ankohen ndaj vendimit të Komitetit disiplinor drejpërsëdrejti në gjykatë. Gjithashtu si aspekt i dytë i rëndësishëm i parashikuar në këtë paketë ndryshimesh në ligjin "Për profesionin e Avokatit në R.Sh" ka të bëjë me procesin e trajnimit që Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet dhe ka për detyrë të trajnojë jo vetëm kandidatët për avokatë por edhe avokatët në detyrë, pra trajnimi fillestar dhe vazhdues.Për këtë nisur nga fluksi i madh i avokatëve të rinj bazuar në faktin që sot në vendin tonë janë në aktivitet akademik 27 fakultete drejtesie 6 nga të cilët janë publik, kuptohet që drejt këtij komuniteti pritet një fluks i madh antarësimi. Kundrejt këtij procesi dhoma ka detyrimin e trajnimit fillestar për gjith këtë kontigjent. Kështu ligji krijoi detyrimin e dhomës që të ngrejë strukturat trajnuese struktura të cilat kulmohen deri në nivel të një shkolle avokati. Për sa sipër së bashku me USAID-in kemi fillar programet pilot të trajnimit fillestar fillimisht në dy qytete Vlorë dhe Durrës dhe sivjet do të shtrihet edhe me gjerë.

**Eshtë hedhur idea për krijimin e dy grupeve të gatshëm të avokatëve, me qëllim zëvendësimin e mbrojtësve ligjorë në seancat gjyqësore. Njëra është ajo aktualja që veprohet me avokatët kryesisht dhe tjetra krijimi i një grupi avokatësh të listuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Ju për cilin model do të ishit?**

Lidhur me këtë pyetje dua të sqaroj se ky është një nga problemet që ka krijuar një ngarkesë të opinionit, ngarkesë e cila ka sjellë që gjithë përgjegjësia lidhur me situatën në gjyqësor të shkarkohet te përfaqësimi dhe pjesmarrja e avokatëve në procesin gjyqsor e veçanërisht atë penal. Sa sipër dua të sqaroj se aktualisht kemi në fuqi një ligj i cili quhet ligji për ndihmën ligjore falas. Gjë që do të thotë se shteti do të afrojë ndihmë juridike falas qoftë në fushën penale qoftë në fushën civile administrative me avokatë ose me klinika ligjore të specializuara për këtë ndihmë.Ky proces dhe këta avokatë nuk do të organizohen dhe nuk do jenë pjesë e strukturave të Dhomës Kombëtare, por do të manaxhohen nga një department i posaçëm brenda strukturave të Ministrisë të Drejtësisë. Ndërsa për të gjithë ata persona që gjykohen në mungesë ose që nuk mund të gjejnë avokatë edhe pse i kanë mundësit financiar, Dhoma Kombëtare e Avokatisë do tju afrojë një listë me avokatë kryesisht, listë e cila miratohet dhe ju vihet në dispozicion Prokurorive pranë Gjykatave si dhe Gjykatave të të gjitha nivele. Nëse këta avokatë të zgjedhur nuk paraqiten në séancë ose thyejnë rregullat e seancës ndaj tyre do të merren masa nëpërmjet procedurave dhe strukaturave disiplinore të miratuara në këtë paketë ndryshimesh, masa të cilat kulmohen deri në heqien e licencës të ushtrimit të profesionit të avokatit.

**Kjo për faktin se procedurat e gjykimit kalonin në afate tejet të gjata, afate këto të cilat bënin që çështja e gjykimit të këtyre masave të humbte aktualitetin ose vet kërkesa nuk ka qënë e bazuar**

**Gjatë këtyre 8 muajve të këtij viti sa është numri i avokatëve që Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka penalizuar me masa administrative, në rastet kur ata kanë thyer etikën apo munguar në mënyrë të vazhdueshme në procese gjyqësore?**

Dua të sqaroj se masa ndaj avokatëve ndaj të cilëve janë paraqitur kërkesa nga klientët, gjyqtarët, prokurorët apo edhe nga vet Ministria e Drejtësisë janë marrë, por zbatimi i procedurave të parashikuara në ligjin aktual kanë bërë që këto masa të cilat kanë varjuar nga vrejtje, gjobë deri në pezullim të lejës të ushtrimit të profesionit të jenë marrë pas një peirudhe gjykimi mbi një vit. Kjo për faktin se procedurat e gjykimit kalonin në afate tejet të gjata, afate këto të cilat bënin që çështja e gjykimit të këtyre masave të humbte aktualitetin ose vet kërkesa nuk ka qënë e bazuar.

## Itali, masakron bashkëshorten në gjumë për xhelozi

Xhelozia është bërë shkak që një 40-vjeçar shqiptar, me banim në Fano, të Italisë, të therë me thikë bashkëshorten e tij, 32-vjeçare. Ngjarja ka ndodhur në banesën e çiftit, prindër të katër fëmijëve. Lajmi është publikuar nga mediat italiane, të cilat e kanë cilësuar një krim për nder, që evokon Kanunin dhe ritet barbare. Sipas tyre, autori, 40-vjeçari Arben Hoxha, është dorëzuar vetë në polici, duke rrëfyer krimin që kishte kryer mbi nënën e 4 fëmijëve të tij. "Kështu duhet të ndodhte", ka deklaruar shqiptari për karabinierët. Sipas të dhënave të para mësohet se viktima, 32-vjeçarja Marjola Hoxha, ishte në gjumë, kur është sulmuar nga bashkëshorti, i cili e ka therur në fyt me një thikë kuzhine. Viktima sapo ishte kthyer nga Shqipëria, ku kishte qëndruar për gati gjithë muajin gusht. Qëndrimi i gjatë i 32-vjeçares është bërë shkak që i shoqi të bëhej xheloz dhe t'i kërkonte të kthehej menjëherë në Itali. Gruaja ishte marrë me dokumentet e dy fëmijëve, binjakë, 5-vjeçar, të cilët kishin qëndruar në Shqipëri. Ditën e krimit, dy vajzat e tjera të çiftit, 12 dhe 14-vjeçare, nuk ndodheshin në shtëpi. Autori është përshkruar si një njeri i qetë dhe jo i dhunshëm, ai punonte prej disa vitesh si murator.

### Prokuroria çliron nga akuzat për vrasje të akuzuarin kryesor Romeo Vide

# Vrasja e Trashanit, pa autor

### Një vit e gjysmë pas vrasjes makabre të Aurora Trashanit, prokuroria ka pezulluar hetimet dhe çështjen penale për mungesë provash, Trashani kushërira e deputetes së PD

**Lajmi**

**Vrasja dhe djegia e 32 vjeçares Aurora Trashani ka mbetur pa autor. Organi i akuzës ka pezulluar çështjen ndërsa ky fakt është konfirmuar zyrtarisht, ndërsa i akuzuari kryesor, rezidenti shqiptar në Gjermani Romeo Vide është ç'liruar nga të gjitha akuzat**


Aurora Trashani

TIRANE

HABJON HASANI

Prokuroria e Tiranës ka pezulluar hetimet në lidhje me vrasjen e 32 vjeçares Aurora Trashani, ndodhur më 1 shkurt të vitit 2011. Aurora Trashani është e afërme e deputetes Arenca Trashani, ajo punonte si juriste në Autoritetin e Konkurencës. Burime nga organi i akuzës konfirmuan pezullimin e hetimeve të cilat zyrtarisht janë pezulluar për shkak se vrasja ka mbetur pa autor, ndonëse një vit më parë prokuroria shpalli në kërkim ndërkombëtar shtetasin shqiptar Romeo Vide, i cili jeton në Gjermani. Një zyrtar i prokurorisë së kryeqytetit tha dje se hetimet janë pezulluar përpara disa javësh, sipas tij arsyeja lidhet me pamundësinë e organit të akuzës për të mbledhur provat e nevojshme për të vënë përpara bankës së të akuzuarve personat e dyshuar si autorë të mundshëm të kësaj ngjarjeje. Si bashkëpuntor në ngjarje u arrestua shtetasi Abedin Mulaj, një taksist që dyshohet se shoqëroi me makinë Viden natën e krimit, por duket se edhe për këtë të fundit provat fillestare të hetuesve kanë qenë të pamjaftueshme pasi Mulaj u lirua me vendim gjykate, pasi thjesht kishte bërë detyrën si taksist natën e vrasjes.

**HETIMET**

Tre javë pas ngjarjes policia dhe prokuroria nisën të dyshonin shtetasin Romeo Vide si autorin e mundshëm të kësaj vrasjeje. Një ditë para ngjarjes, i dyshuari, i cili jeton në Gjermani, i ka telefonuar Abedin Mulajt dhe i ka thënë ta priste në aeroport, kjo pasi ata kanë një njohje 4-5 vjeçare. Abedin Mulaj ka shkuar në aeroport dhe ka marrë të dyshuarin. "Mbrëmjen e kësaj dite, i dyshuari i ka thënë taksistit të shkonte ta merrte pranë Zogut të Zi, vend në të cilin Abedini e ka pritur në makinë pothuajse 30 minuta", thuhet në vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurisë së taksistit Abedin Mulaj. Sipas hetimeve të prokurorisë, Aurora Trashani u qëllua 60 herë me thikë në trup dhe më pas banesës së saj iu vu zjarri, me qëllim zhdukjen e gjurmëve të krimit në shtëpinë me qira ku ajo jetonte, në rrugën "Don Bosko". Sipas hetimeve të Prokurorisë, referuar edhe mesazheve të shkëmbyera mes të dyshuarit dhe viktimës në Facebook, Trashani pak ditë para vrasjes, i kishte komunikuar personit tjetër se donte të shkëpuste marrëdhënien me të. Sipas prokurorisë, pasi ka marrë këtë lajm, i dyshuari ka ardhur në Shqipëri nga Gjermania dhe mbrëmjen e 1 shkurtit 2011 rreth orës 09:30, ka shkuar në banesën e Aurora Trashanit. Aty dyshohet se mes viktimës dhe vrasësit ka nisur një debat, i cili ka përfunduar me vrasjen e 32-vjeçares. Të nesërmen, ajo u gjet pa jetë, ndërsa banesa ishte djegur.

**PEZULLIMI**

Por ndonëse i kërkuar ndërkombëtarisht Romeo Vide nuk është paraqitur asnjëherë në vendin tonë për të dhënë shpjegimet përpara hetuesve. Ai caktoi një avokat për të mbrojtur ndërsa policia e kërkonte. Duket se gjithçka ka marrë fund muajin e kaluar kur prokuroria ka pezulluar hetimet mbi këtë çështje, duke vendosur se nuk kishte prova direkte që e lidhnin të dyshuarin me vrasjen. Në fakt në shtëpinë e Trashanit nuk janë gjetur gjurmë të vrasësit dhe hetuesit e kishin ngritur akuzën mbi të bazuar kryesisht te dëshmia e taksistit Mulaj i cili tha se e kishte marrë të dyshuarin me taksi te "Zogu I Zi" natën e vrasjes. Vendi I përshkruar nga taksisti është shumë pranë shtëpisë së viktimës dhe shtuar kësaj këmbimet e mesazheve në Facebook, policia e shpalli Viden të dyshuarin kryesor. Por jo për shumë kohë, pas një vit pas ngritjes së akuzës ndaj tij, Vide nuk është më i akuzuar për këtë ngjarje të mbetur pa autor.

**Hetimi**

## Trashani, si vrasës u dyshua një emigrant i martuar

Romeo Vide për një vit rresht akuzohej dhe kërkohej si autori kryesor i masakrimit me thika të 32-vjeçares shkodrane, Aurora Trashani. Ai është 49 vjeç. Ka lindur në Lushnjë dhe familjarisht është vendosur në Tiranë vite më parë. Është baba i dy vajzave të rritura, Rovena 27 vjeçe dhe Flonja 22-vjeçe, fëmijë që kanë ardhur në jetë nga martesa me një bashkëqytetaren e tij, e quajtur Vera. Romeo Vide mësohet se është rezident në Gjermani bashkë me familjen e tij, ndërsa me viktimën e 1 shkurtit, Aurora Trashanin, rezulton të jetë njohur prej më shumë se një viti nga interneti. Nga të dhënat që disponon grupi i hetimit, të dhëna që kanë dalë nga dëshmitë e të njohurve të Trashanit, është bërë me dije se në muajin janar kanë nisur edhe kontradiktat e mëdha mes tyre, kontradikta që grupi i hetimit pretendon që i disponon edhe në formën e mesazheve elektronike dhe të sms-ve telefonike.

Vrasja në versionin hetimor.

Sistemi TIMS ka fiksuar hyrjen për në Shqipëri të Romeo Vides më datë 1 shkurt në orën 14:40 minuta dhe është larguar më datë 3 në orën 13:20 minuta. Para se të merrte avionin për në Rinas, mësohet se në numrin e tij të celularit që përdorte në Gjermani 00491...905, ka telefonuar pikërisht taksistin e tij, Abedin Mulaj i cili e ka pritur në Rinas dhe e ka sjellë te "Zogu i Zi". Në vendimin e gjykatës së Tiranës, për hetimin mbi personin e arrestuar tashmë si bashkëpunëtor i tij, saktësohet se me të njëjtin numër telefoni ka komunikuar sërish me Mulajn dhe i ka kërkuar të vinte e ta merrte atje ku e kishte lënë. Ora e ritakimit të tyre është fiksuar ajo 22:20 e mbrëmjes së 1 shkurtit. Prej aty, Romeo dhe Abedini kanë shkuar në shtëpinë e këtij të fundit në Kombinat dhe taksisti është ngjitur në apartamentin ku banonte nëna e Romeos, ka takuar atë dhe të motrën e saj dhe më pas është larguar.

**Njoftimi**

# Zjarret, mbeten aktive edhe 17 vatra

TIRANE



Ministria e Brendshme bëri të ditur se edhe gjatë ditës së djeshme, forcat e PMNZSH-së, atyre të Armatosura dhe Shërbimit Pyjor, kanë vijuar operacionet për vënien nën kontroll, izolimin dhe fikjen e zjarreve. "Rreth 500 efektivë të FA-ve, në të gjithë territorin e vendit, kanë vijuar të mbështesin forcat zjarrfikëse dhe ato të Shërbimit Pyjor. Operacionet nga ajri të helikopterit të tipit Cugar, vënë në dispozicion nga Republika Sllovene, me mbi 30 hedhje uji (4 tonë), mundësuan fikjen e vatrës së zjarrit në Malin e Dajtit. Ndërkohë që dy avionet e tipit Canader të dërguar nga Republika Italiane dhe ai turk me kapacitete 8 ton, vijuan operacionet në verlindje të vendit, duke kryer rreth 68 hedhje uji mbi vatrat e zjarrit. Operacionet nga ajri do të vijojnë në zonën verilindore, bazuar në planin e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, të miratur nga Ministri Flamur Noka, deri në shuarjen e plotë të vatrave të zjarrit."- thuhet në njoftimin e Ministrisë së Brendshme. Në të gjithë qarqet e vendit, rezultojnë 17 vatra aktive zjarresh. Qarku Dibër Ka 5 vatra aktive zjarri. Pavarësisht ndërhyrjes së vazhdueshme nga ajri vatrat e zjarrit në "Liqeni i Bruçit" , "Liqeni Zi"në Parkun Kombëtar Lurë, në Kacni vazhdojnë të jenë aktive. Qarku Kukës ka aktive 3 vatra zjarri aktive. Vatra e zjarrit në vendin e quajtur Rrethi i Bardhë, mbi fshatin Kukaj, komuna Margegaj, e cila vazhdon të jetë problematike. Qarku Shkodër ka aktive 6 vatra zjarri. Në Rrethin Shkodër ka 1 vatër zjarri në fshatin Balza, komuna Shosh, Në rrethin Malësisë së Madhe 1 vatër zjarri, në fshatin Fushën e Zezë, komuna Kastrat. Ndërsa në Rrethin Pukë, vazhdojnë 4 vatra zjarri aktive, në fshatin Iballë, komuna Iballë, në fshatin Orosh, komuna Qafë Mali. Ndërsa qarqet e Gjirokastrës, Korçës, Lezhës dhe Vlorës kanë ende nga një vatër zjarri aktive.

# Diplomati shkrimtar

**DYZIMI** *i ambasadorit të Shqipërisë në Paris. Mes detyrës së vështirë të diplomacisë dhe të krijimit artistik. Telashet dhe fama pas romanit "Rrëfenjë me ndërkombëtarë" dhe filmi i pritshëm për familjen Popa*

# YLLJET ALIÇKAJ

## Një film për zhgënjimin nga Perëndimi

### Kthimet në Tiranë dhe roli i përfaqësuesit të një vendi të vogël

TIRANE
ROLAND QAFOKU

**Ambasadori i Shqipërisë në Paris, Ylljet Aliçkaj, në një rrëfim për politikën, diplomacinë dhe artin kujton romanin "Rrëfenjë me ndërkombëtarë", që shkroi kur ishte në Tiranë dhe jehona e tij, pasi godiste diplomatët e huaj të llastuar nga vëmendja që u kushtohej në Tiranë. Tani është vetë diplomat, por pa i prerë lidhjet me artin, letërsinë dhe krijimtarinë.**

**Do ta vazhdoj intervistën aty e kam lënë për herë të fundit që ju kam intervistuar, në të cilën keni thënë se gjëja që ju bën më shumë përshtypje kur vini nga Parisi në Shqipëri janë plehrat. Vazhdoni ta keni këtë mendim?**

Është e lehtë të bësh kritizerin kur vjen nga një vend më i zhvilluar e sidomos nga Parisi, por përsëris se fenomenin e plehrave nuk e justifikon dot, pasi është një një çështje kulture. Ne çdo pikë mund të gjesh një justifikime nëse flet për imazhin e Shqipërisë, por plehrat janë impakti i parë. Megjithatë shoh shumë përmirësim, në Tiranë, në shumë rrugë të Jugut, tendenca është pozitive, por gjithësesi mbetet një problem. Pasi ka ende ka kodra me kapica plehrash, të cilat në vende europiane përpiqen ta mbushim me lule. Pa dashur të bëj politikë, u entuziazmova duke lexuar shtypin atëherë, ku thuhej se qeveria e vuri në një nga prioritet edhe pse për mendimin tim u vu vonë si prioritet, por ama gjithësesi u vu.

**Si duket Shqipëria nga Parisi, sipas jush?**

Kur jeton jashtë të ke një sedër kombëtare më të fuqishme sesa je në Shqipëri dhe elemente që të shkasin kur je në Shqipëri. Atje t'i bëhesh më i ndjeshëm pasi duket sikur të prekin vendin tënd dhe sikur të prekin edhe ty individualisht. Pra e shoh Shqipërinë me më shumë dashuri dhe më me interes. Shpesh herë e konsultoj edhe me emigrantët e tjerë në Francë dhe Itali thonë se i merr malli për Shqipërinë, edhe pse zakonisht e fshehin, pasi e përligjin jetës jashtë duke thënë "ja këtu nuk ikin dritat ka wiskey coca-cola" (qesh), por pas pak tregojnë problemet që kanë me të jetuarin jashtë. Ndaj them që nuk e tregojnë menjëherë, por e kanë të gjithë të fshehur dhe duan të kthehen, por një pjesë nuk i le sedra, ose një pjesë tjetër janë konsoliduar tashmë aty. Çdo vend ka specifikën e tij të marrëdhënies së perceptimit atje, po të jesh në Shqipëri bëhesh kritizer shumë i madh, ndërsa kur jeton jashtë përpiqesh ta idealizoh vendin tënd.

**Në një intervistë, kur sapo ishit emëruar ambasador në Francë më keni thënë këto fjalë "Unë premtoj dhe synoj të quhem një ambasador i mirë me një kontributr sado modest në të mirë të vendit tim". A keni mbajtur këtë premtim?**

Fjali e përgjithshme kjo... Çdo individ hyn tek protagonizmi i identitetit të tij dhe do të bëjë më të mirën atje ku



Ylljet Aliçkaj

> **Filmi**
>
> Bëhej fjalë për gjashtë individë të cilët kishin pritur Godonë në ambjentet e ambasadës italiane dhe përveçse faktit të futjes së ambasadës më tërhoqi ballafaqimi me realitetin rutinë të Perëndimit.

punon, për shumë arsye. Nuk është e lehtë dhe pesha është shumë e madhe në këndvështrimin Francë-Shqipëri. E thënë pa modesti është puna e një ambasadori normal. Kam zbatuar ato gjëra që hyjnë jo vetëm në rutinën e punës, por edhe në atë që mund ta quajmë të improvizimit brenda normës, për prioritetin që ka pasur çështja shqiptare, ajo e Kosovës, apo që kanë pasur të bëjnë me inevstimet me ekonominë dhe nuk pretendoj se kam bërë një boom në marrëdhëniet mes dy vendeve.

**Një ndër arsyet përse kërkova këtë intervistë me ju është edhe se ju keni publikuar romanin tuaj "Valsi i lumturisë", pak muaj më parë. Ju keni shkuar këtu për herë të parë e zeza mbi të bardhë historinë e vëllezërve Popaj. Përse e rikthyet në vëmendje këtë histori?**

Një autor nuk mund ta shpjegojë dot sesi lind një ide, por fillesa ka qenë një shkrim në gazetën italiane "Corriere della sera", shumë i koncentruar, lakonik, por dhe shumë i hidhur që fliste për fatin e katër motrave dhe dy vëllezërve të familjes Popa, mbi degradimin shpirtëtor dhe shpërbërja e gjithë shpresës të kapjes së "Perëndimit". Bëhej fjalë për gjashtë individë të cilët kishin pritur Godonë në ambjentet e ambasadës italiane dhe përveçse faktit të futjes së ambasadës më tërhoqi ballafaqimi me realitetin rutinë të Perëndimit. Në këtë libër jepet përballja e ëndrrës së shqiptarëve me ëndrrën e Perëndimit me realitetin rutinë të tij, që nuk ishte as i mirë dhe as i keq, por që nuk u përputh me atë imazhin fals që u krijua në Shqipëri. Unë nuk i kam takuar anëtarët e kësaj familjeje, por di që kanë përfunduar keq, në kuptimin që janë zhgënjyer.

**Ku janë sot ata?**

Nuk e dua të hyj në detaje, pasi tashmë ata janë të moshuar e të sëmurë, por di që patën probleme në Itali dhe jo për faj të vendit, por nuk gjetën atë që kishin ëndërruar, pasi ranë pre e asaj rutine dhe ligjeve dhe trajtimit të atij vendi. Duke qenë të parët që mundën të largoheshin, ata ishin të parët që u përballën me këtë realitet gjë që solli dhe degradimin e tyre dhe mosintegrimin e tyre total. Romani është i hidhur dhe i zi, ai është bërë edhe skenar filmi, por në shoqëritë italiane nuk e kanë pranuar, pasi thonë se në të del keq Italia. Këta individë kanë qenë të parët, e theksoj, duke u izoluar për pesë vjet në bodrum, duke mos parë asnjëherë diellin me sy dhe kjo shkaktoi më pas edhe sëmundje dhe pritën që në Itali do të priteshin si heronj. Ata u përballën aty me burokracira dhe me racizëm, ndaj dhe projekti i filmit pati vështirësi në Itali dhe tani do të realizohet nga producentë francezë.

**Kur do të kemi fatin që ta shohim të përfunduar këtë projekt?**

Në kinema është bërë aq e vështirë për të bërë një film me metrazh të gjatë, sa ti nuk e di nëse do të ndodhë pas dytre muaj, por mund të ndodhë edhe pas dy vjetësh, pasi kërkon harmonizimin e shumë faktorëve. Deri tani janë bërë bashkë disa producentë, një francez, një grek, një italian, por pa ndihmën e Cinecitta dhe gjithashtu do të jetë edhe një producent shqiptar.

**Aktorët do të jenë vetëm shqiptarë, apo edhe të huaj?**

Shqiptarë po sepse edhe personazhet janë të tillë. Unë kam kërkuar shumë pas këtij shkrimi, i cili në fakt kritikonte qeverinë italiane, e cila u tregua indiferente në atë dhe pas një bujë shumë të madhe që pati kjo histori ajo u kthye në një ngjarje shumë banale. Kanë qenë shumë të pasura arktivat me këta individë që kanë lidhje me negociatat për lirimin e tyre, ndaj besoj se do të këtë edhe aktorë të huaj.

**Keni ndonjë aktor që e preferoni dhe doni të jetë patjetër?**

Kjo është një pyetje shumë delikate, pasi janë shumë aktorë, por di këtë që Shqipëria ka aktorë shumë mirë, duke nisur që nga klasikët, si Robert Ndrenika, Mirush Kabashi, Ndriçim Xhepa, Timo Flloko e për të ardhur tek Luiza Xhuvani. Fatkeqësia është hapësira e



Në foto: Shkrimtari dhe diplomati Ylljet Aliçkaj

pakët që gjen kultura e një vendi të vogël në Europë edhe duke mbajtur nën kurriz çështjen e imazhit. Doja të theksoja diçka që ne ende nuk jemi të ndërgjegjshëm për dëmin që i sjell Shqipërisë çështja e imazhit.

**Në dokumentarin tashmë të njohur edhe për shqiptarët "Shqipëria vendi përballë" i realizuar nga "LUCE", citohet edhe një frazë e Ismail Kaderesë, në të cilën thuhet se Italia, një vend i zhvilluar ekonomikisht, jepte lajme edhe nga Xhibuti e Zanzibari i Afrikës dhe nuk shkruante për Shqipërinë. Çfarë ishte e gjitha kjo, indiferencë?**

> **Ne kemi nevojë ta njohim Francën apo Italinë për aq sa këto vende hyjnë në vizionin e interesave dhe perceptimeve tona. Francezi nuk e ka mendjen tek Shqipëria, madje shpesh herë të thonë "Ah është ai vendi ku mafia është shumë e egër".**

Ka qenë mospërfillje, ndaj një vendi që u vetëizolua. Përpjekje janë bërë nga perëndimorët dhe nuk janë dakort me atë që thuhet se një ishte një braktisje e plotë e Shqipërisë, sepse përpjekje politike janë bërë, por duke qenë se dështuan e lanë në vetizolimin e saj. Për ta kapërcyer këtë pyetje duhet thënë se ky lloj indiferentizmi është edhe tani. Shqipëria nuk është në qendër të vemendjes, është çështja e Kosovës që ka rëndësi për çështjen e gjeostrategjisë së Ballkanit, por nuk është se Shqipëria ka vëmendje të madhe shpesh herë janë njohur me fenomene negative si trafikut të drogës e prostitucionit, të cilat vijojnë dhe nuk janë as më shumë e as më pak

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**Grumbullim Drithi SH.A. Kavajë**

**N J O F T I M**

Njoftohen të gjithë Aksionerët e Sh.A Grumbullim-Drithit se ditën e mërkurë datë 26 Shtator 2012 në orën 15:00 në ambjentet e shoqëris bëhet mbledhja e asambles me këtë rend dite:

**1.** Miratimi i statutit të ri - **2.** Zgjedhja e organeve drejtuese - **3.** Të tjera

**Adresa: Lagjia nr. 2, pranë fushës së vjetër të sportit Kavajë**

**ÇDO VEND** *ka specifikën e tij të marrëdhënies së perceptimit atje, po të jesh në Shqipëri bëhesh kritizer shumë i madh, ndërsa kur jeton jashtë përpiqesh ta idealizoh vendin tënd.*

**DUKE QENË TË PARËT** *që mundën të largoheshin, Popajt ishin të parët që u përballën me këtë realitet gjë që solli dhe degradimin e tyre dhe mosintegrimin e tyre total. Romani është i hidhur dhe i zi.*



sa ç'janë në vende të tjera. Çdo vend i huaj të njeh për aq sa ka nevojë të të njohë. Ne kemi nevojë ta njohim Francën apo Italinë për aq sa këto vende hyjnë në vizionin e interesave dhe perceptimeve tona. Francezi nuk e ka mendjen tek Shqipëria, madje shpesh herë të thonë "Ah është ai vendi ku mafia është shumë e egër".

**Libri "Rrëfenjë me ndërkombëtarë" për mendimin tim është një ndër pesë romanet më të mira pas '90-ës në Shqipëri, pasi ju shkelni në një territor që askush nuk kishte guxuar të shkelte më parë dhe mes humorit dhe sarkazëm s'keni arritur të stigmatizoni vlera dhe vese të ndërkombëtarëve. Përse mendoni se ky libër vijon të pëlqehet?**

Nga një anë ai roman "po më merr në qafë" pasi edhe pse nxjerr libra të rinj, më thonë se nuk është aq i mirë se "Rrëfenjë me ndërkombëtarët". Nëse e shoh si shkrimtar me "Valsin e lumturisë" ndihem më i sigurt si shkrimtar, kurse atë e bëra me një mllef personal duke e përzier dhe pak me shkrimtarinë. Mendoj që ai roman edhe pse është bërë rreth shtatë vite që është botuar do jetë ende aktual në Shqipëri në lidhje me dinjitetin e raporteve me të huajt në vend, pra me demitizimin e të famshmit, apo të rëndësishmit. Shoh që ndërkomëbarët befasohen nga vlerësimin e këtushëm dhe shumica e tyre përkedhelen.

**Por edhe këtu kanë filluar kritikat e para.**

Unë jam kundër kritikave për tu treguar trim.

E themi më konkretisht analisti Mustafa Nano ka bërë një nga shkrimet me kurajoze, duke bërë një analizë të të gjithë ambasdorëve duke thënë se përse ata duhet të na diktojnë ne gjithçka që ndodh në politikë.

Nuk dua të bëj një konsatim absolut, por dua të them diçka të kundërt, se Shqipëria pa ndihmën perëndimore nuk e kapërcente dot tranzicionin. Gjithashtu duhet pranuar se shumë vlera si kultura e institucionit në Perëndim janë shumë të mira se në Shqipëri. Ne ndonjëherë kritikojmë për tu treguar trima, por duhet përcaktuar nëse kritikon për të zgjidhur fenomenin apo të kritikosh njerin për ndonjë arsye. Në këtë kuptim shpesh herë kam parë fraza në shtyp që janë denigruese. "Rrëfenjë me ndërkombëtarë" është një roman artistik dhe këtë e them se dua të mbrohem, por në shtyp një herë kam lexuar se një ambasador quhej langaraq dhe kjo nuk është etike dhe kam përshtypje se kjo bëhet vetëm për të treguar trimërinë e individit.

**Ju nuk keni patur shqetësime për këtë roman?**

Shqetësime pata, por këto i quaj histori të kaluara.

**Sa e njohur është në Francë letërsia shqipe, përjashto këtu Kadarenë?**

Është e njohur dhe ndonjëherë mjafton një shkrimtar dhe në rastin konkret mjafton fenomeni Kadare dhe fakti që del një shkrimtar nga një vend i vogël si Shqipëria tregon se ky vend nuk është pa gjë. Krahas Kadaresë, Fatos Kongoli është bërë i njohur, nuk flas për këtu në dimensionet e një shkrimtari të njohur, por nëse shkon në një librari dhe i thua Kongoli, atyre ky emër u thotë diçka. Duhet të kemi parasysh se në katër sezone botimesh që janë në Francë botohen 16 mijë libra artistike dhe në të gjitha këto botime në një vit duhet të penetrosh dhe të bësh që shtypi dhe televizioni të flasë për ty. Ti duhet të hysh në këtë garë me emra nga e gjithë bota dhe do të ishte sukes i madh nëse për ty shkruan "Le Monde" apo "Figaro" dhe kjo mund të sjellë një rritje të shitjeve. Është shumë e vështirë të hysh në këtë garë, ata që përpiqen e kuptojnë këtë. Shumë kolegë të mi, ashtu si dhe unë bartim imazhin e një vendi të panjohur, bartim imazhin e keq dhe rrezikun komercial të botuesve. Shpesh herë ne harrojmë që një botues i huaj apo lexues francez e ka tepër të vështirë për të orientuar vlerën e një shkrimtari në dallim nga kontektsi i caktuar, pasi ai nuk e njeh realitein dhe kjo është pengesë shumë e madhe. Letërsia shqipe është njohur në Francë për aq sa peshë dhe vlerë ka.

**Përveç Kongolit a ka shkrimtarë të tjerë?**

Në Francë janë botuar rreth 12 apo 13 shkrimtarë.

**A blihen apo lexohen ata?**

Jo, ata blihen.... P.sh Besnik Mustafaj është botuar nga shtëpi botuese të mira apo dhe Ornela Vorpsi, Besa Myftiu dhe gjithçka varet nga potencialet e shtëpive botuese. "Rrëfenjë me ndërkombëtarë" nuk ka patur sukses në Francë sepse ndoshta unë bëra një zgjedhje të gabuar duke e botuar në një shtëpi botuese të vogël. Nëse kjo ndodh atëherë libri praktikisht është i vdekur. Gjithçka ka të bëjë me nivelin e shtëpisë botuese.

**Si janë marrëdhëniet e Shqipërisë me Francën?**

Shumë të mira. Ka matës të ndryshëm që tregojnë marrëdhëniet mes dy shteteve, por p.sh Franca ishte shumë pozitive në mbështetjen e Shqipërisë për anëtarësimin në NATO, ka qenë gjithmonë bashkëshoqëruese e proçesit të integrimit. Ka një interes gjithnjë e në rritje dhe marrëdhëniet politike janë gjithnjë të mira dhe kjo matet nga vizitat. Për të qenë realist nuk është se Shqipëria është në qendër të interesave të politikës së jashtme franceze, por për aq sa janë interesat marrëdhëniet mes dy vendeve janë shumë të mira.

**Cili është mendimi juaj për Fransua Holondë, a ka ndryshuar diçka në marrëdhëniet me Shqipërinë?**

Kam një mendim shumë të mirë për të, ndërsa përsa i përket çështjes së dytë, këto janë shtete të mëdha me një inerci institucionale të fuqishme që nuk ndodhin ndryshime të mëdha, edhe pse natyrisht ka nuancime.

**A janë xhelozë politikanët francezë për faktin që Shqipëria ka prioritet marrëdhëniet me SHBA?**

Unë nuk e kam ndjerë hapur, por çdo shtet e di hapësirën e interesave reciproke dhe përpiqet të përmirësojë me përfitime të ndërsjellta, dëmtuar askënd. Nuk ka keqkuptime në këtë rast dhe nuk është shprehur ndonjëherë drejtpërdrejt.

**A do ta marrë Shqipëria sipas jush statusin e vendit kandiatat për në BE në muajin tetor?**

Besoj se po, por këto çështje nuk i parashikon dot sepse ka shumë faktorë të cilët jo domosdoshmërisht lidhen me përmbushjen e kërkesa. Ka faktorë si ato të lobit të zgjerimit megjithatë kam shpresë se do të realizohet. Ne mendojmë se i gjithë Perëndimi, apo institucionet dhe organizatate kanë vëmendjen tek çdo detaj i brendshëm i marrëdhënieve mes shqiptarëve. Nuk e ka kush mendjen tek këto dhe ne shpesh herë i vemë stërkëmbsha njëri-tjetrit për këtë çështje. Perceptimi është global, sidomos opinioni publik nuk e ka kohën për këto gjera. Duhet të jetë Shqipëria prioritet.

**Po përse në Tiranë ekziston perceptimi se po nuk u pajtuan Rama dhe Berisha nuk do të ketë status? Është normale që opozita të bëjë një opozitë të fortë sepse atë funksion ka.**

Une kam një mendim personal në lidhje më këtë çështje. Thuhet se opoziat ka rolin e saj vetëm për të bërë kritikë, por druaj se ndonjëherë i humbet thelbi shkakut të kritikës, a bëjet kjo vetëm për të marrë pushtetion, apo unë të kontrolloj qeverisjen tënde në favor të shoqërisë. Nuk jam dakort me këtë moto "shaj shaj, kritiko kritiko", kushdo qoftë në opozitë, pasi ti humb thelbin e kritikës. Rrallë dëgjoj që nj politikan një politikan apo që qeveria dhe opozita të vlerësojnë një veorim të njëra tjetrës.

**...ai roman "po më merr në qafë" pasi edhe pse nxjerr libra të rinj, më thonë se nuk është aq i mirë se "Rrëfenjë me ndërkombëtarët"...**

**Gjatë kohës që ju jeni emëruar amabsador keni ndërruar disa ministra, a i keni pasur problem ndërrimet e tyre?**

Personalisht jo, unë kam pasur relata normale me të gjithë ata.

**Shumë studentë shqiptarë studiojnë në Francë por edhe në vende të tjera europiane, duke krijuar tashmë një plejadë. Si e parashikoni të ardhmen e Shqipërisë me këta të diplomuar në Europë me përballjen e atyre studentëve që janë diplomuar në Shqipëri. A mendoni se do të ketë një përballje mes tyre?**

Këtë pyetje ia bëj dhe unë vetes por dihet se universitetet e huaja janë shumë më lart se ato në Shqipëri, por dihet edhe diçka tjetër që klasa intelektuale ose teknike e mjekëve apo inxhinierëve që kanë dalë nga universitet shqiptare ka qenë e fortë. Arsimi ka probleme në Shqipëri dhe është një plagë e rëndë, por teknicientët shqiptarë apo edhe muzikantë apo artistë po ecin në fushat e tyre në botë. Fillimisht ka pasur një rezistencë për atë që quhet "Brain Gain", por si tendencë e përgjithshme nëse ke mbaruar Harvardin ke një favor më të madh dhe besoj se kjo është një tendencë në rritje. Kjo është edhe një tendencë botërore në selektimin e universiteteve, madje ndonjëherë kalojnë edhe në nivele raciste.

**Si i vlerësoni studentët shqiptarë në Francë?**

Janë realisht shumë të mirë. Në francë nuk ekziston ai lloj diferencimi i univesiteteve sa në SHBA, por p.sh. në Sorbonë ka studentë shumë të mirë shqiptarë dhe t'i ndihesh krenar kur sheh diplomat e tyre të shkëlqyera.



FOTOLAJM

## Kadare, paradite te Liqeni, foto me admiruesen

Shkrimtari i shquar shqiptar, Ismail Kadare ka zgjedhur mjediset e liqenit artificial te Tiranës për të kaluar paraditen e të martës. “Shqiptarja.com” fiksoi në 11.30 momentet kur Kadare, i shoqëruar nga botuesi i tij, Bujar Hudhri, po mbaronin shëtitjen. Në ato momente një vajzë e re nga Shkodra, e cila e kishte pikasur shkrimtarin që nga vendi ku pinte kafenë vrapon drejt tij dhe kërkon të bëjë foto me të dhe ai pranon me kënaqësi. Shkrimtari shqiptar, edhe këtë vit është në listën e të nominuarve për çmimin Nobel për letërsinë, por kësaj radhe në vend të katërt për të pretenduar çmimin për letërsinë.

*Strehimi*

**PËRFITUESIT** *banorë të shtëpive me pronarë, marrin kredi me interes zero me shlyerje për 30 vjet*

# Jepen kreditë për 3.289 familje

## Nëse familjet e përfshira në listë nuk janë larguar brenda datës 1 nëntor, Enti Kombëtar i Banesave ka të drejtën e thirrjes së përmbaruesve për largimin nga shtëpitë

**TIRANE**

Enti Kombëtar i Banesave ka hartuar tashmë listën e qytetarëve, të cilët duhet të lirojnë shtëpitë e pronarëve, ku ata banojnë që para vitit 1991. Lista përbëhet nga 3.289 familje, të cilat do të përfitojnë brenda datës 1 nëntor kredi me interes 0 dhe me pagesë brenda 30 vjetëve për të blerë shtëpi të re. Zëdhënësja e Ministrisë së Punëve Publike, Arminda Qylafku, u shpreh se pjesa dërmuese e këtyre familjeve gjenden në qytetet e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës. Të gjithë ata pronarë apo qytetarë që nuk e gjejnë emrin e tyre në këtë listë, mund të paraqiten pranë Entit Kombëtar të Banesave për të dorëzuar dokumentacionin. Enti duhej të dorëzonte listat e përfituesve të kredisë brenda datës 5 shtator.

**BASHKIA TIRANË**

Abaz Selami Bazeli
Abdullah Sulejman Myrtaj
Abdurrahman Maliq Pinari
Abdyl Mehmet Jahja
Adelina Kosturi
Adile Muhin Cocoli
Adnan Dibra
Adriatik Ismail Kallulli
Aferdita Hasan Dalti
Aferdita Shaqir Bruzi
Aferdita Shefqet Jonuzi
Afije Ali Dervina
Agathaniqi Stavro Konomi
Agetina Pejo+Pirro Rakipi
Agim Mehmet Zoto
Agim Muca
Agim Qazim Balla
Agim Qazim Karazi
Agim Qazim Shehu
Agim Sadik Bocaj
Agim Xhafer Sulejmani
Agim Xhelal Caslli
Aglai Bani Gjanci
Agron Bajram Bardhi
Agron Myrteza Bedeni
Agron Abdyl Aliaj
Agron Caushi
Agron Fejzi Hoxha
Agron Ibrahim Tafa
Agron Pajtim Haxhiraj
Agron Rahman Kambeci
Agron Xhevit Dalla
Ahamide Sulo Bardhi
Ahmet Bajram Dervishi
Ahmet Dule Saliasi
Ahmet Hasan Reci
Aishe Hajredin Suti
Albert Gjovalin Shllaku
Albert Ismail Babo
Albert Nasi Buda
Albert Vangjel Mara
Albert Vasil Millona
Aleksander Anastas Cama
Aleksander Bedri Shtepani
Aleksander Ilia Nimali
Aleksander Kristofor Baka
Aleksander Milo Varfi
Aleksander Ndue Gjeci
Aleksander Stefo Duni
Aleksander Vasil Baguca
Aleksander Vasil Konomi
Alfred Lec Shkreli
Alfred Nikollaq Zoga
Alfred Perolli
Ali Abdyl Abdihoxha
Ali Hysen Zefraj
Ali Hyso Ganaj
Alket Faruk Reka
Alma Haki Cara
Alma Mazllum Toska
Ambezeze Shyqyri Kurti
Ana Petro Dovana
Anastas Vasil Cama
Anastasi+Besnik Shambli
Andi Astrit Koka
Andon Pandi Çerepi
Andoneta Kristaq Lubonja
Andrea Ferit Dhiaj
Andrea Josif Dode
Andrea Kristo Gjokrushi
Andrea Thoma Marto
Anife Mataj
Anife Ymer Veliu
Antonin Jozef Malecek
Arben Fejzi Hoxha
Arben Njazi Zekthi
Arben Rustem Trafiku
Arben Ali Abdihoxha
Arben Kudret Alikaj
Arben Lasku
Arben Nezmi Bajrami
Arben Papuli
Arben Rahman Kambeci
Arben Zyhdi Basha
Ardi Stavri Nici
Ardian Muca
Ardian Spiro Lito
Argjir Apostol Vaso
Arilla Leonidha Tasho
Aristotel Spiraku
Aristulla Harallamb Shuti
Arjan Dhimosten Verli
Arjan Enver Hysa
Arjan Lamçe
Arjan Selim Rusi
Artan Skender Arifi
Artan Fejzi Gorica
Artan Zeman Bardhi
Artur Qordja
Artur Shaban Lundra
Artur Xhevat Shemaj
Asllan Xhafer Budlla
Astrit Avni Koka
Astrit Faik Zepishta
Astrit Ismail Gjeta
Astrit Myftar Ceno
Ateme Qazim Caushaj
Athina Filip Vasili
Aurel Gjergji Shato
Avdyl Shefki Bejo
Avni Hetem Bakiasi
Avni Mustafa Kokaj
Avram Perikli Sotirllari
Baftjar Hajredin Mehmetllari
Bahri Muharrem Agovi
Bahri Zenel Rudi
Bajram Mehmet Hasani
Bajram Sherif Koci
Bajram Sherif Kurti
Bajram Veizi
Baki Fazlli Gjebrea
Ballem Qyshka
Bardhyl Islam Kapedani
Bardhyl Muharrem Cano
Bardhyl Neki Shima
Bardhyl Saliko Zani
Bardhyl Uka
Bashkim Hydai Bejo
Bashkim Kumi
Bashkim Musa Tomini
Bashkim Mustafa Martiri
Bashkim Sadik Osmani
Bashkim Sala Magjistari
Basri Riza Musabetlli
Bedri Ali Shtepani
Bedri Halili
Bedri Shefki Copani
Bedrie Mahmut Tila
Bedrie Shaban Zelka
Bedrije Riza Lami
Beglije Ramis Sejdini
Bektash Kasmi
Beqir Qerim Kalemi
Beqir Mustaf Nurishaj
Beqo Hadush Musaraj
Besa Nazmi Baraku
Besim Muharrem Celi
Besim Shaqir Dibra
Besnik Gurtali Spaho
Besnik Enver Bali
Besnik Fejzi Kadareja
Besnik Maksut karaj
Besnik Rexhep Tusha
Bilal Gani Kurti
Bledar Kristaq Dollaku
Bojko Kristo Themelko
Bora Qamil Gjuzi
Brahim Xhevit Fikaj
Bujar Korb Lici
Bujar Ahmet Duhanxhiu
Bujar Dalip Doci
Bujar Ferizaj
Bujar Hysen Rama
Bujar Saliko Zani
Bujar Shyqyri Hyka
Bukuri Thanas Mema
Bukurie Ismail Daja
Bukurie Naum Gjogjini
Cen Manxhar Hoxha
Çerçiz Xhelo
Cezar Agron Aliaj
Çlirim Neshat Hysi
Dalip Mehmet Hodo
Dashamir Fehim Ramkaj
Xhemal Hysenbelliu
Maksut Zenelaj
Demir Rahmi Pojani
Demir Osman Gashi
Demir Xhemal Hyka
Dhimiter Jorgji Dhima
Dhimiter Spiro Adhami
Dhimiter Stavro Dhimitri
Dhimitra Stavro Bozo
Dhimitraq Anesti Bellovoda
Dhiogjen Thoma Kokali
Dhora Aristotel Taci
Dhurata Mihal Qirko
Diana Shaban Lundra
Dilaver Ahmet Jashari
Doloreza Nasho Kroi
Drita Jahja Jakupi
Drita Sotir Ruvina
Drita Stafa Hasan
Drita Xhixha
Drita Zenun Bejko
Dritan Siliqi
Dritan Veli Kaleshi
Dukagjin Jorgji Leka
Dule Shefik Bejo
Dylber Tufa
Edmond Andrea Gjokrushi
Edmond Deli Karaj
Edmond Gaqo Gjini
Edmond Gogo Jorganxhi
Kozma Samarxhi
Ligor Konomi
Edmond Nexhmi Tartari
Edmond Nikolin Pepa
Edmond Pandeli Jorgo
Eduart Dukagjin Leka
Eftimia Aleks Mihali
Eglantina Sefer Hima
Elefkon Islam Poci
Eleni Pashko
Elham Qani Zahaj
Eli Selfo Caushaj
Elmaz Ali Manellari
Elmaz Sinoimeri
Elva Jani Pema
Emihan Zija Xhunglini
Emiliano Agron Mucollari
Emiliano Pavllo Asduriani
Emin Selim Luniku
Emine Sulejmani/Qerimi
Enver Ilmi Tushe
Enver Isuf Ceno
Ermira Fadil Paja
Ervehe Skender Avdullai
Esat Sali Xhepa
Esat Shaban Alliu
Estref Masar Hoxholli
Evgjeni Aleksander Kostallari
Fabiola Dod Margjoni
Fadil Haxhi Furiku
Faredin Karafil Ahmeti
Fatbardha Bajram Sefa
Fatime Sadik Osmani
Fatime Ahmet Reci
Fatime Hamit Lame
Fatime Ismail Alikaj
Fatime Mahmut Banushi
Nevruz Kadareja
Fatime Qamil Shima
Fatjon Sadik Osmani
